



- Kuvendi dhe kriza e marsit
- Partneritet i ri ndërmjet institucioneve kosovare dhe bashkësisë ndërkombëtare
- Politikat për rininë dhe arsimimin
- Si të kenë të tri gjuhët një zë të vetëm legjislativ?

Editoriali



Sanimi i gjendjes pas trazirave

Të martën më 16 mars, në Prishtinë për herë të parë u mbajt "mbrëmja parlamentare". Me këtë rast, deputetë të parlamentit, ministra, këshilltarë politikë, si dhe përfaqësuesë të bashkësisë ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile u takuan në një atmosferë mjaft të përzemërt. Kjo nismë, ishte parashikuar që të shërbejë si forum për diskutime politike joformale, një ditë para mbajtjes së mbledhjes plenare të Kuvendit. Mirëpo, në të njejtën kohë, për fat të keq, shpërthyen trazirat në mënyrë dramatike.

Atë ditë, banorët serbë të Kosovës nga fshati Çagllavicë bllokuan rrugën kryesore Prishtinë-Shkup për të protestuar kundër incidentit me ç'rast ishte plagosur një banor vendas. Në mbrëmjen e asaj dite në fshatin verior të Çabrës tre fëmijë shqiptarë u mbytën në lumin Ibër. Këto dy incidente të ndara shkaktuan dhunën, që zgjati për tri ditë resht në Kosovë. Dhuna u përhap në tërë Kosovën dhe ishte e drejtuar kryesisht kundër serbëve të Kosovës, por edhe kundër komuniteteve tjera dhe UNMIK-ut.

Bashkësia Ndërkombëtare dhe politikanët kosovarë u befasuan me shpërthimin dhe përmasat e dhunës. Në mbrëmjen e 17 marsit udhëheqësit e lartë kosovarë u takuan me PSSP-në dhe përfaqësuesit e shteteve të Kuintit për të apeluar për ndaljen e dhunës, duke theksuar me këtë rast domosdoshmërinë e zgjedhjes së çështjeve në mënyrë institucionale. Në fillim, disa politikanë të nivelit qëndror u drejtoshin protestuesve për të shfaqur zhgënjimin e kahmotshëm të tyre ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Mirëpo, shumë deputetë dhe ministra, u angazhuan për të ndaluar dhunën, përmes takimeve nëpër komuna, degë të partive, me aktivistë partiakë dhe media lokale. Kështu, pas pakënaqësisë së shprehur nga ana e akterëve kryesorë ndërkombëtarë ndaj reagi-meve jo aq të fuqishme të disa politikanëve kryesorë kosovarë gjatë krizës dhe pas saj, Kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Nexhat Daci në mbledhjen plenare me 25 mars, mbajti një fjalim të jashtëzakonshëm, me ç'rast dënoi fuqishëm dhunën, në përgjithësi dhe dhunën kundër qytetarëve serb dhe ashkalinjë, shtëpive të serbëve dhe kishave ortodokse, në veçanti. Me këtë rast, ai mbështeti iniciativën e Qeverisë për krijimin e një fondi për riparimin e dëmeve të shkaktuara. Ndërsa politikanët serbë të Kosovës nuk u prononcuan, zyrtarët e Beogradit reaguan lidhur me trazirat. Në raporte të ndryshme dhe analiza vlerësohej se pjesë të caktuara të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë dështuan në menaxhimin e situatës së shkaktuar

Shkaqet që sollën deri tek këto rrëime në shoqëri janë të ndryshme dhe komplekse. Dihet mirëfilli se Kosova është akoma duke

u përballur me shumë probleme dhe së këndejmi, njerëzit kanë mjaft arsye që të jenë të pakënaqur. Ka pak vende të punës dhe ekonomia nuk zhvillohet me ritmet e duhura për të kënaqur nevojat e një popullate të re. Për më tepër, mospajtimet politike mes UNMIK-ut dhe institucioneve kosovare kanë dobësuar besueshmërinë e të gjitha institucioneve qeverisëse, gjë që ka krijuar përshtypjen se Kosova e ka humbur rrugën drejt progresit dhe se nuk mund të ofrojë ndonjë të ardhme të ndritshme për rininë e saj. Shpërthimi i dhunës në mars ka provuar se kjo shoqëri ka probleme shumë të thella dhe se nuk ka institucione të fuqishme dhe të afta që të përballen me trazirat e shkaktuara, të ngushëllojnë rininë e traumatizuar si dhe të mbajnë nën kontrollë atë pakicë kriminale të dhunshme.

Pastaj, ekziston çështja e statusit final të Kosovës. Pasiguria e vazhdueshme nuk ndihmon stabilitetin në vend. Kështu, ndërsa bashkësia ndërkombëtare ka krijuar politikën e vet madhore "Standardet para Statusit", udhëheqësit shqiptarë vazhdojnë të kërkojnë kompetenca më të mëdha, të cilat do t'ua bënin të mundur atyre që të merren me problemet shoqërore, ekonomike dhe institucionale në rritje dhe njëherësh t'i përmbushin standardet.

Pas krizës së marsit, PSSP-ja ka ofruar një partneritet më të madh ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare. Plani i implementimit të standardeve përmban në detaje gjithë planin: objektivat, obligimet e secilit, planin kohor dhe vlerësimin. Së këndejmi, plani u ofron mundësi udhëheqësve të Kosovës, që të merren me çështje dhe probleme institucionale, ekonomike dhe shoqërore. Mirëpo, për fat të keq, politikanët serbë të Kosovës kanë refuzuar të marrin pjesë në proceset thelbësore të krijimit të politikave, madje edhe atëherë kur ato drejtpërdrejtë prekin interesat e komuniteteve të tyre.

Për të parandaluar një kollaps të ardhshëm të shkallës më të gjerë, lipset që të fuqizohen institucionet kosovare dhe të zhvillohet një perspektivë më e mirë për rininë. Në suazën e këtyre përçapjeve-ndonëse përgatitjet tanimë janë bërë- është edhe hapja e zyreve në Kryeministri për çështjet, që bëjnë pjesë në të drejtat e rezervuara të UNMIK-ut, për të cilat janë duke u zhvilluar bisedime intensive midis Zyrës së Kryeministrit dhe UNMIK-ut. Vlen të vihet në dukje se OSBE-ja dhe organizatat tjera partnere të "Iniciativës për Mbështetje Kuvendit" kanë mbajtur një sërë konsultimesh si me udhëheqësinë e Kuvendit, ashtu edhe me deputetë për të bërë rishqyrtimin e punës së tyre dhe për të thelluar partneritetin me këtë institucionin. Kuvendi ka formuar një komision hetues për krizën e marsit. Ministrinë dhe administrata publike do të duhej të përqëndroheshin më tepër në jetësimin e legjislacionit të miratuar, për të siguruar sundimin e ligjit.

"Sanimi i gjendjes pas trazirave" nënkupton riparimin e dëmeve të shkaktuara gjatë marsit dhe zhvillimin e mekanizmave të reja për të forcur autoritetin politik dhe funksionimin e gjithëmbarshtëm të institucioneve kosovare. Kjo kërkon monitorim, ngritje të kapaciteteve dhe përgjegjësi politike.

*Frenklin De Vrieze,
Kordinator i ASI-it*

Ne duhet ta zbulojmë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën

Pas krizës së parë të vërtetë sociale në Kosovë që nga filltet e Institucioneve të Përkohshme Vetë-qeverisëse, Kuvendi i Kosovës e themeloi Komisionin për Hetime lidhur me krizën e marsit. Prof. Alush Gashi, anëtar i këtij Komisioni, bisedoi me ASI-n për punën nismëtare të këtij Komisioni.

Uli Steinle, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Prof. Gashi, cili është fushëveprimi i punës së Komisionit për Hetime?

Në seancën e parë të Kuvendit pas ngjarjeve të tmerrshme që papritur ndodhën në Kosovë, Kuvendi diskutoi për idenë e themelimit të një "Komisioni Hetues" ad hoc, dhe më pas e miratoi këtë më 9 prill. Sipas vendimit me shkrim të seancës plenare, në mandatin tonë duhet t'i hetojmë arsyet dhe pasojat e ngjarjeve të 17/18 marsit. Për këtë arsye më së shumti do të përqendrohemi në ngjarjet aktuale, por brenda një kohe të caktuar lipset analizuar shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve. Në planin tonë të veprimit ne jemi duke i shqyrtuar edhe intervistat me IPVQ-të, me ndërkombëtarët në pozita të larta në Kosovë si edhe me udhëheqësit e komuniteteve, qytetarët individualë dhe me shoqërinë civile.

Tani pasi që është themeluar Komisioni, cilat janë aktivitetet tuaja të ardhshme?

Në fazën e parë ne i kemi mbledhur të gjitha raportet si dhe hulumtimet e bëra lidhur me ngjarjet që janë me interes për IPVQ dhe qytetarët e Kosovës, siç janë mungesa e shtrirjes së sovranitetit të UNMIK-ut në tërë territorin e Kosovës dhe ekzistenca e strukturave të papranueshme paralele në Kosovë. Pasi që ky është "Komisioni Hetues" i parë parlamentar na është dashur që të konsultohemi me parlamentet e tjera evropiane për t'i shqyrtuar procedurat e tyre rreth veprimtarive të ngjashme. Ne kemi përfutur nga shërbimet e mira të Iniciativës për Përkrahje të Kuvendit (ASI) dhe nga ekspertiza e Parlamentit të Holandës, Parlamentit të Shqipërisë dhe parlamenteve të tjerë për t'i përpiluar rregullat tona të

procedurës, të cilat ne kemi ndërmend t'ia propozojmë Kuvendit si amandamente për Rregulloren e tanishme të Punës për komisionet hetuese në të ardhmen.

Themelimi i një "Komisioni Hetues" është diçka e re për Kuvendin e Kosovës. Çka mendoni ju, cila do të jetë sfida më e madhe me të cilën do të ballafaqohet Komisioni?

Pasi që kjo është hera e parë që po bëhen hetime parlamentare, ne duhet të sigurohemi dhe të provojmë se aktiviteti ynë i menduar është që ta zbulojmë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Ne gjithashtu duhet të sigurohemi që kjo në asnjë mënyrë nuk është hetim policor. Ky është një hetim parlamentar. Ne do t'ia ofrojmë rekomandimet tona seancës plenare.

A ndiheni i përkrahur nga Sekretariati i Kuvendit dhe nga anëtarët e tjerë të Kuvendit?

Për shkak të vështirësive aktuale në Kuvend, pra numri i pamjaf-tueshëm i zyrave dhe personelit, Sekretariati dhe Kryesia e Kuvendit kanë bërë ç'kanë mundur për të na siguruar një këshillëtar ligjor dhe personel teknik. Dhe natyrisht ka vështirësi në punën e përditshme për shkak të mungesës së hapësirës, por ky është realiteti për të gjitha IPVQ Kosovare.

Sa mendoni se do të zgjasë puna e Komisionit derisa ta hartojë raportin përfundimtar?

Fushëveprimi i hetimeve është mjaft i gjerë dhe ato duhet të jenë të sakta dhe tepër praktike, pa ndonjë ndikim të jashtëm politik. Për këtë arsye nevojitet më shumë kohë se një muaj, sa është paraparë në vendimin e Kuvendit.

Çka do të mund të shtonte raporti i Komisionit analizave që tashmë ekzistojnë?

Ky është një hetim parlamentar dhe jo një raport i dedikuar për jashtë. Ky duhet të jetë një raport i njerzve të zgjedhur dhe jo i hetuesve ose individëve të paguar me një filozofi mohimi, të cilët i drejtojnë akuzat e tyre në anën tjetër për të kërkuar arsyetime.

Unë nuk besoj se kjo është dyfishim i hetimeve. Parlamenti do t'i qaset çështjes në mënyrë më të gjithanshme se sa shkatërrimi fizik i tanishëm, i cili ka ndodhur.

A do t'i ftojë Komisioni edhe përfaqësuesit nga bashkësia ndërkombëtare, si p.sh. Policinë Civile, UNMIK-un dhe KFOR-in për të dëshmuar?

Ne me kënaqësi do të kërkojmë me këtë rast që ata t'i këmbëjnë me ne mendimet e tyre. Për kushtet nën të cilët kjo mund të ndodhë mund të bisedohet.

Duke pasur parasysh faktin se anëtarët e koalicionit "Kthimi" ende janë duke e bojkotuar punën e Kuvendit, si do të siguroni se pikëpamja e komunitetit serb shqyrtohet në Komision?

Ata janë pjesë e institucioneve të Kosovës dhe ne presim që të sillen me përgjegjësi. Ne do t'i vizitojmë komunitetet serbe dhe minoritetet e tjera në tërë Kosovën dhe do t'i dëgjojmë mendimet e tyre.

A mendoni se raporti i Komisionit do të jetë i pranueshëm për të gjitha grupet politike në Kuvend-përfshirë këtu edhe koalicionin "Kthimi"?

Detyra jonë është që të përgatisim një raport i cili do të jetë shumë i sigurt dhe i argumentuar nga dokumentet në seancën plenare.



Alush Gashi

Pastaj prej anëtarëve të Kuvendit do të varen analizat, debatet dhe vendimet. Këto janë detyrat e tyre. Mandati ynë ka filluar me vendimin e Kuvendit dhe ne do të mbarojmë me vendimin e Kuvendit, që mund ta pranojë ose hedh poshtë raportin.

Komisioni juaj është duke e bërë një punë që nuk është bërë më parë, pasi që ky është Komisioni i parë hetues i Kuvendit. A e shihni ju këtë si model dhe a shpresoni se kjo do të bëhet një institucion në kuadrin e Kuvendit?

Në Komision kemi koncensus për të bërë çmos për të krijuar procedura të mira si dhe një kulturë bashkëpunimi gjatë hetimeve, prandaj nëse kjo do të kontribuojë që të bëhet model për komisionet e ardhshme, ne do të jemi të nderuar.

Anëtarët e Komisionit për Hetime

Alush Gashi, LDK
Nekibe Kelmendi, LDK
Hydajet Hyseni, PDK
Gani Sadik, KDTP-OC
Zylfije Hundozi, AAK

“Të punojmë së bashku”

Me 9 prill 2004 PSSP Hari Holkeri mbajti një fjalim para Kuvendit të Kosovës në një mbledhje të jashtëzakonshme të tij, me rastin e krizës së marsit. Në vazhdim po sjellim tekstin e fjalimit të tij të mbajtur me atë rast.

Këto janë ditë të vështira për Kosovën. Tre javë më parë, ne i përjetuam ngjarjet që ishin të tmerrshme dhe tronditëse. Për shkak të dhunës, sot nuk na janë bashkuar përfaqësuesit e bashkësisë serbe, edhe pse vendi i tyre legjitim duhet të jetë këtu, me ne, duke e diskutuar të ardhmen tonë të përbashkët. Mua më vjen keq për këtë.

Gjatë dy ditëve të dhunës brutale, u shuan 19 jetëra, u shkatërruan 730 shtëpi, 29 kisha dhe manastire – shumë prej tyre të ruajtura si trashëgimi kulturore e gjithë njerëzimit – u dëmtuan dhe u shkatërruan, dhe më se 4000 banorë të Kosovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Unë bashkëndiej me të gjithë ata që kanë vuajtur gjatë këtyre ngjarjeve të tmerrshme, duke i përfshirë edhe familjet e fëmijëve të gjorë që u mbytn në Mitrovicë.

Ju shpreh ngushëllime familjeve të atyre që e humbën jetën në këtë dhunë të pakuptimtë.

Populli i Kosovës e njeh dhimbjen e dhunës nga përvoja e tij e hidhur kohë më parë. Dhuna e vitit 1999 e shtyu bashkësinë ndërkombëtare t’i ndihmojë popullit të Kosovës të shpëtojë nga ajo tragjedi. Dhe tani dhuna po përsëritet dhe po kërcënon ta shkatërrojë investimin e popullit të Kosovës dhe të miqve të tyre ndërkombëtarë – vetëm pesë vite më vonë.

Unë i kam vizituar vendet e shkatërruara, kam biseduar me viktimat dhe banorët e Kosovës. E di që kjo dhunë nuk ka qenë vepër e tërë shoqërisë. Ka qenë vepër e një grupi të vogël të njerëzve që e kanë planin e tyre për Kosovën. Plani i tyre është një Kosovë në të cilën ata qeverisin

përmes dhunës dhe kërcënimit, duke e mbajtur tërë popullin e Kosovës peng për qëllimet e tyre.

Atyre nuk duhet lejuar që ta realizojnë planin e tyre. Duke punuar së bashku ne do t’i shpartallojmë ata. Dhuna, pavarësisht nga motivi dhe viktima, duhet të dënohet, patjetër. Ata që e ushtrojnë dhunën duhet të ballafaqohen me ligjin; ata që e nxisin atë duhet të izoloohen, plotësisht.

Udhëheqësit e vërtetë të Kosovës e dinë këtë. Ata tashmë kanë reaguar për t’ju bërë të ditur viktimave të dhunës se njerëzit e ndershëm dhe të përgjegjshëm të Kosovës do t’i zhdëmtojnë ose riparojnë dëmet fizike që u janë shkaktuar shtëpiave dhe vendeve të kultit.

Udhëheqësit e vërtetë të Kosovës poashtu e dinë që dëmi që i është shkaktuar shpirtit të Kosovës duhet të përtrihet poashtu. Ata tashmë janë paraqitur me porosinë për pajtim dhe rikrijim të harmonisë shoqërore

Unë propozoj që në ditët e ardhshme të organizojmë një takim të udhëheqësve politik, të qeverisë dhe të UNMIK-ut për t’i shqyrtuar hapat praktikë për fillimin e rikrijimit të besimit të humbur ndërmjet bashkësive.

Ne në UNMIK, ju në Kuvend, udhëheqësit politikë dhe anëtarët e qeverisë, jemi të një mendimi për këtë. Ka vetëm një rrugë që na shpije përpara dhe na mëson se si t’i shporremi kësaj fatkeqësie, dhe ajo është duke punuar së bashku. Të gjithë duhet të marrim barrën e përgjegjësisë.

UNMIK-u e di rolin e tij. Ne do t’i identifikojmë dhe do t’i nxjerrim



PSSP Hari Holkeri

në gjyq ata të cilët kanë përdorur dhunë. Hetimet e policisë tashmë kanë konstatuar raste penale ndaj shumë bërësve të dhunës së marsit. Shumë të tjerë do të dalin në gjyq për krimet e tyre.

Ne duhet të marrim mësim nga ajo që ka ndodhur. Do të emërohet një organ për shqyrtim, nën një udhëheqje të pavarur, për ta shqyrtuar reagimin e UNMIK-ut ndaj dhunës. Ne do t’i zbatojmë rekomandimet e tij.

Edhe UNMIK-u e pranon përgjegjësinë për të siguruar mundësi ekonomike, të cilën e kërkon tërë populli i Kosovës me të drejtë. Zotohem se do të vazhdoj ta shtyj përpara procesin e privatizimit si mënyrë për ta plotësuar këtë kërkesë. Do ta bëj këtë në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës.

Rruga e mëtejme prej këtu mund të jetë e vështirë, por tanimë është e qartë. Para pesë muajve,

u trasua rruga e ardhshme për Kosovën. Shpallja e datës së rishikimit për vlerësimin e statusit të Kosovës e ka bërë të qartë, si kurrë më parë, drejtimin që shpie përpara, një rrugë e përkrahur nga udhëheqësit e Kosovës, Këshilli i Sigurimit, BE-ja dhe nga të gjithë miqtë dhe përkrahësit e Kosovës.

Në dhjetor, unë dhe kryeministri, të shoqëruar nga shu-më udhëheqës kosovar, e parashtruan vizionin për të ardhmen në "standardet për Kosovën". Ai vizion është shpjeguar thjeshtë. Standardet e parashikojnë një shoqëri de-mokratike ku sundon ligji që i mbron të gjithë qytetarët; respektin për diversitetin e pasur kulturor dhe etnik të Kosovës; stabilitet dhe prosperitet që ofron jetë të denjë për të gjithë. Është një vizion që kur të sëndërtohet do ta çojë Kosovën drejt një të ardhmeje të ndritshme në Evropë dhe në komunitetin ndër-kombëtar.

Javën e kaluar, kryeministri Rexhepi më shoqëroi gjatë shpalljes së planit për zbatimin e standardeve. Ky plan dëshmon qartë për hapat që duhet t'i ndërmarim për ta sëndërtuar këtë vizion. Plani do të jetë punë e vështirë por do realizuar atë. Unë e di që udhëheqësit e vërtetë të Kosovës janë poaq të vendosur sa edhe unë, që ne duhet të vemi përpara për ta arritur vizionin për Kosovën e atillë siç e dëshiron populli i saj.

Nuk e kuptojnë dhe nuk e mbështesin këtë vizion të gjithë udhëheqësit e Kosovës. Disa po e përkrahin mostolerancën dhe nganjëherë madje edhe po u duartrokas in atyre që e kanë përdorë dhunën.

Disa madje i quajnë këta kriminelë heronj. Disa prej tyre mund të kenë marrë pjesë në rezistencën kundër një regjimi shtypës dhe brutal para vitit 1999. Por ekziston një dallim shumë i madh midis luftës kundër shtypjes dhe sulmit kundër të pafajshmeve. Të gjithë duhet



PSSP Holkeri, Kryetari Rugova, Kryeministri Rexhepi dhe anëtarët e Kuvendit

ta kuptojmë që këta njerëz janë duke punuar kundër të ardhmes së Kosovës, kundër popullit të Kosovës. Duhet shporruar nga ata. Heronjtë që i nevojiten Kosovës sot janë njerëzit që dëshirojnë ta ndërtojnë një shoqëri të re me të ardhme në Evropë. Populli i Kosovës do të ketë rast t'i mbështes ata kur ta zgjedh Kuvendin e ri të Kosovës me 23 tetor këtë vit. Ky do të jetë një sinjal të cilin do ta mirëpresin dhe duartrokas in miqtë e Kosovës.

Jam i lumtur të them që Kosova ende ka shumë miq. Vizitat që u bën pas dhunës së marsit nga sekretari i përgjithshëm i NATO-s, nga udhëheqësit e Bashkimit Evropian, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës na kanë vënë në dijeni të gjithëve, që ata dëshirojnë të na ndihmojnë për të arritur vizionin e "standardeve për Kosovën". Lajmërimi i Z. Grosman për një "Grup përkrahës për Kosovën", do të na

ndihmojë të ecim drejt asaj dite kur të fillojmë ta konsiderojmë vendin e ardhshëm të Kosovës në Evropë dhe në botë.

Ai vend do të definohet varësisht nga ajo se si do t'i arrijmë standardet. Përparimi do të sigurojë një Kosovë të sigurtë dhe stabile ku populli i saj do të jetojë në paqe, në një Kosovë që do të ketë marrëdhënie stabile me fqinjët e saj. Por nëse nuk do të ketë përparim, do të vazhdojë pasiguria, duke ofruar vetëm një të ardhme të zymtë për të gjithë popullin e Kosovës.

Ka të tillë që thonë se është e pamundur që bashkësitë e Kosovës të jetojnë së bashku në paqe. Ata e theksojnë dhunën e marsit dhe shumë akte të dhunës të drejtuara kundër njërës apo tjetrës bashkësi. Ata kërkojnë ndarje; ata mendojnë që Kosova e ndarë është e vetmja rrugë përpara.

Ajo është rrugë e dëshpërimit. Nuk ka të ardhme për askë, për

asnjë bashkësi në një Kosovë të ndarë. Por ne duhet të provojmë se vizioni ynë është ai i drejtë duke krijuar fakte pozitive. Faktet pozitive që duhet t'i krijojmë ne janë të përkufizuara mirë. Këto fakte pozitive janë "standardet për Kosovën".

Rruga përpara nuk do të jetë e lehtë. Pothuajse të gjithë në Kosovë e njohin dhimbjen e dhunës. Shumë të tjerë ende e njohin mjerimin e varfërisë. Të punuarit së bashku në partneritet është mënyra jonë e vetme për t'u marrë me dhimbjen dhe me vështërsitë e vërteta.

Porosia ime për ju, porosia ime për tërë Kosovën është që të vazhdojmë të punojmë për arritjen e këtij vizioni. Unë jam partneri juaj. Me bashkësinë ndërkombëtare në krah, unë ua zgjas dorën juve në mënyrë që të mund ta ndërtojmë së bashku një Kosovë të atillë çfarë ju duhet dhe si e dëshironi ju. Le të punojmë së bashku.

Deklarata të udhëheqësve të partive politike të Kosovës mbi ngjarjet e marsit



PSSP, liderët e Kosovës, KFOR-i dhe vendet e Kuintit në adresimin televiziv më 17 mars

Pas përkeqësimit dramatik të situatës së sigurisë në Kosovë, veçanërisht pas sulmeve të shqiptarëve ndaj komunitetit serb dhe romë, gjithë vëmendja ishte përqëndruar në reagimet e udhëheqësve kosovarë dhe institucioneve kosovare lidhur me ngjarjet tragjike. Në vijim do të lexoni një përmbledhje të shkurtër të deklaratave më interesante të politikanëve kosovarë mbi zhvillimet e fundit tragjike. Gjithashtu mund të lexoni edhe deklaratat e akterëve kryesorë ndërkombëtarë të involvuar në politikën kosovare, që do tu ndihmojnë të kuptoni më mirë mënyrën sesi njerëzit e përfshirë në vendimmarrje janë përballur me krizën.

Qeveria është takuar më 17 mars në një mbledhje të jashtëzakonshme kushtuar dhunës në Kosovë. Qeveria ka kërkuar nga i dërguari special Holkeri organizimin e një takimi mes faktorëve relevantë në Kosovë (KFOR, UNMIK, PISG).

Kryeministri Bajram Rexhepi apelon tek qytetarët që të jenë të qetë përkundër pakënaqësive ndaj lëshimeve të kaluara. Qeveria shpreh keqardhje për vdekjen tragjike të tre fëmijëve në Çabër, viktima të urrejtjes ndëretnike. Të gjitha ngjarjet duke filluar me sulmin me granatë në Shtëpinë e Kryetarit Rugova, mbyttjen e fëmijëve dhe përleshjet e 17 marsit, kryeministri i quajti "rrethi i dhunës" dhe ftoi autoritetet përgjegjëse të bëjnë çmos për të zbardhur shkaqet e këtyre ngjarjeve.

PSSP-ja Hari Holkeri, përfaqësuesit e shteteve të Kuintit, udhëheqësit shqiptarë të Kosovës më 17 mars: "48 orët e kaluara kanë qenë tronditëse dhe të tmerrshme për qytetarët e Kosovës. Kërkojmë që të pranojnë ngushëllimet tona të gjitha familjet e të vrarëve dhe të plagosurve. Por dhuna duhet të ndalet menjëherë. Nuk ka arsytim për asnjë akt dhune.

Kurrë nuk ka arsye për tu sulmuar apo përdhunuar fqiu. Aktet e tilla nuk tolerohen dot. Ato janë humbje për të gjithë. Gjithë atyre që tani ndodhen në rrugë apo po marrin pjesë në demonstratë u themi "Kthehuni në shtëpi tani". Policia dhe KFOR-i do të përkujdesen për sigurinë e të gjithëve në Kosovë ndaj duhet mundësuar atyre që të kryejnë detyrat e veta. Për ngjarjet e sotshme dhe ato të ditëve të kaluara do të bëhen hetime dhe ndaj përgjegjësve për vrasje dhe akte të dhunshme do të ngriten padi. Ne jemi këtu për të ndërtuar një shoqëri të sigurtë për të gjitha grupet etnike në Kosovë. Nuk do të lejojmë që tërë mundi dhe vullneti i mirë të shkatërrohen mbrenda disa orëve. Është koha që secili të marrë përsipër përgjegjësinë për veprimet e veta dhe të punojë për një shoqëri të paqësore për të gjithë. Media duhet të sillt me përgjegjësi e jo të shtojë tensione me deklaratat dhe raporte të pabazuara. Është në interesin

e të gjithë qytetarëve që të mbi-sundojë ligji dhe njerëzit të kthehen nëpër shtëpitë e tyre dhe familjeve të tyre."

Komunikata për shtyp e LDK-së më 17 mars: LDK-ja shpreh shqetësimin mbi situatën e krijuar në Mitrovicë si dhe pjesë të tjera të Kosovës. LDK kërkon nga subjektet përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe ligjit (KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut) të demonstrojnë nivel të duhur të përgjegjësisë dhe të zbatojnë masat e nevojshme për të parandaluar eskalimin e mëtejshëm të situatës. LDK-ja i lut qytetarët e Kosovës të jenë të qetë dhe të bëjnë çmos për të normalizuar situatën. LDK-ja gjithashtu shpreh ngushëllimet familjeve të fëmijëve të mbytur në lumin Ibër dhe gjithë familjeve pjesëtarët e të cilëve humbën jetën gjatë dhunës."

Komunikata për shtyp e PDK-së më 17 mars: Dhuna e organizuar e strukturave paralele serbe e udhëhequr nga

Sërbia dhe politika e saj mori dimensione makabre me vrasjen e tre fëmijëve në lumin Ibër... Intoleranca ka arritur kulmin ndërsa indinjata e shprehur e popullit është legjitime ..sërbët po keqpërdorin vullnetin e mirë të shqiptarëve për të krijuar një shoqëri të barabartë për të gjithë. Ngjarjet që ndodhën para dy ditëve dhe këto të djeshmet po e dëshmojnë këtë. Nuk është e vërtetë se sërbët nuk po kanë mundësi të integrohen, por ata po refuzojnë që të integrohen në shoqërinë kosovare. Edhe pesë vite pas përfundimit të luftës, ata ende i mbeten besnik dhunës ndaj shqiptarëve. Prandaj, kjo nuk mund të tolerohet më. PDK-ja është e gatshme të mbështesë politikën që shpiejnë drejt ndërtimit të një shoqërie ku të gjithë do të jenë të barabartë para ligjit.”

Komunikata për shtyp e AAK-së më 17 mars: “AAK nuk e pranon situatën e krijuar nga institucionet paralele dhe bandat kriminale. AAK-ja konsideron që institucionet paralele janë faktori kryesor i krijimit të situatës së këtillë në Kosovë ... Këto struktura dhe bandat kriminale kanë provokuar vepërimtari ilegale dhe vrasje të qytetarëve të Kosovës. Politika e gabueshme e UNMIK-ut dhe KFOR-it, të cilët kanë toleruar strukturat paralele vetëm sa ka acaruar dhe destabilizuar akoma më shumë situatën në Kosovë. Ne kërkojmë nga KFOR-i mbylljen e kufirit me Sërbinë në pjesën veriore të Mitrovicës për të parandaluar hyrjen e bandave kriminale serbe në Kosovë. Përkundër aktivitetëve ilegale të banorëve të Gracanicës dhe Selo/Llapiplaselle, këkojmë nga qytetarët të kthehen në shtëpitë e tyre dhe mos të kontribuojnë në përkeqësimin e situatës edhe ashtu të tensionuar.”

Komunikata për shtyp e Shtabit të TMK-së më 18 mars: “Shtabi i TMK-së është shumë i shqetësuar me situatën në Mi-

trovicë dhe Çagllavicë. TMK u shpreh ngushëllimet më të thella familjeve të të vvarëve dhe uron shërim të shpejt gjithë të lënduarve. Ndonëse TMK është e vetëdijshme se po tejkalon kompetencat e veta, për hir të qetësisë të situatës, apelojmë tek qytetarët që të ruajnë gjakftohtësinë në këtë situatë të jashtëzakonshme. Jetërat e njerëzve janë gjëja më e vlefshme për ne, ndaj dhe do të bëjmë çmos për të mbrojtur qytetarët dhe për të shmangur eskalimin e mëtutjeshëm të situatës. Ne i kuptojmë brengat e qytetarëve, por megjithatë kërkojmë që t’u jepet mundësia institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që të zgjedhin problemin e Mitrovicës dhe çështjet tjera me interes në mënyrë institucionale.”

Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës, më 17 mars ka deklaruar: “Në momentin kur sulmohet Presidenti dhe kur fëmijët detyrohen të kërcejnë e të gjejnë vdekjen me metoda para-historike, dhe kur një i ri serb lëndohet, atëhere çfarë mund t’u ofrojmë qytetarëve si institucione dhe ç’mund të kërkojmë nga ata.”

Hashim Thaqi, Kryetar i PDK-ës, më 18 mars ka deklaruar që “kosovarët dhe ndërkombëtarët (së bashku) nuk e kanë shpallur luftën për Kosovën të banuar vetëm nga shqiptarët.” Ai bëri apel për “paqe, maturi dhe respekt të ndërsjellë, si dhe për respekt ndaj grupeve tjera etnike.” Z. Thaqi iu referua faktit që në sajë të partneritetit me vendet e Perëndimit dhe krahas rezistencës së shoqërisë qytetare u arrit liria e Kosovës. Ai apeloj tek qytetarët që të kuptojnë dhe mirëpresin angazhimin ndërkombëtar në Kosovë, përfshirë këtu edhe UNMIK-un.

Ramush Haradinaj, Kryetar i AAK-ës, më 18 mars ka deklaruar: “Mendoj se nuk është shfaqur dhunë kundër forcave

të sigurisë, si p.sh ndaj KFOR-it. Kjo është revoltë e qytetarëve ndaj status quos dhe gjendja e krijuar do të jetë me pasoja për proceset dhe gjithë çfarë kemi arritur në Kosovë deri tani.”

Zëdhënësi i UNMIK-ut Derek Çapell më 17 mars deklaroi: “Situata në Kosovë është kaotike... Ka pasur dhunë edhe më parë, por tani është fjala për veprime të koordinuara. Dhuna ka filluar në disa vende njëkohësisht, gjë që na bën të përfundojmë se këto janë veprime të planifikuara më parë.”

Dr. Ibrahim Rugova, Kryetar i Kosovës dhe Kryetar i LDK-së më 18 mars u bëri thirrje qytetarëve t’i kthehen jetës normale dhe të përmbahen nga sulmet ndaj KFOR-it dhe UNMIK-ut. “Protestat e tilla dëmtojnë imazhin e Kosovës dhe procesin e pavarësisë, dhe u shkojnë përshkati armiqëve tanë”.

Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) në një konferencë për shtyp deklaroi se eskalimi i dhunës më 17 mars është rezultat i sulmeve të armatosura në pjesën veriore të Mitrovicës dhe enklavat tjera serbe. Kryetari i LPK-së (Emrush Xhemajli) tha që paqja dhe rendi në Kosovë do të kthehen në Kosovë vetëm

atëherë kur kërkesat e popullit të jetësohen. Ai ka kritikuar Kryeministrin Bajram Rexhepi për siç tha ai mosangazhimin e tij në çështjet prioritare por u ka hyrë ca pseudo-dialogjeve, të cilat në fakt do të fillojnë vetëm atëherë kur të pushojë njëherë e përgjithmonë agresioni i Sërbisë ndaj Kosovës dhe kur të bëhet njohja e shtetit të pavaruar të Kosovës.

COMKFOR Holger Kamerhof më 18 mars ka njoftuar se NATO ka urdhëruar shtimin e forcave rezervë në Kosovë: “Kam urdhëruar komandatët e brigadave multinationale të KFOR-it të përdorin forcën proporcionale për të siguruar ushtarët tanë dhe njerëzit e pafajshëm dhe për të rikthyer lirinë e lëvizjes në tërë Kosovën,” deklaroi Kamerhof.

Sekretari gjeneral i NATO-s Jap de Hup Shefer para vizitës në Kosovë më 22 mars: Asnjëri në Kosovë nuk duhet të mendojë, kjo vlen posaçërisht për komunitetin e mazhorancës në Kosovë, shqiptarët, se duke nxitur dhunë, ata do të mund t’i arrijnë më lehtë ambiciet e tyre politike. Në të vërtetë, do të nevojitet një kohë shumë më e gjatë para se ta arrijë këtë”



Demonstratat e shoqërisë civile kundër trazirave

Si të rivendoset besimi

Zoran Qulafiq, gazetar me honorar për B-92

Deri disa muaj më parë koalicioni "Kthimi", sipas vlerësimeve të shumë analistëve, ishte një nga grupet parlamentare më aktive në Kuvendin e Kosovës dhe dukej sikur proceset demokratike po hynin në një fazë të re plotësisht pozitive. Megjithatë, vala e dhunës në muajin mars solli shumë pyetje lidhur me të gjithat që ishin ndërtuar në pesë vitet e fundit.

Deputetët e Koalicionit "Kthimi" tani nuk e përcjellin punën e Kuvendit dhe është një pikëpyetje e madhe se kur do të ulen aty përsëri. Anëtari i Kryesisë së Kuvendit Oliver Ivanoviq është i mendimit se 17 marsi zvogëloi gati të gjitha efektet pozitive të arritura deri tani, dhe në këtë rast, bashkësia ndërkombëtare në Kosovë do të duhet që të bëjë më tepër përpjekje për ta rikthyer besimin e dëmtuar rëndë të serbëve në institucionet e Kosovës.

"Ne sot duhet të bëjmë një hap para, sepse nëse hetimet i përfshijnë vetëm ata që janë përgjegjës për 17 marsin dhe të shtojmë ta përfshijnë dhunën ndaj serbëve që nga viti 1999, duket se ne nuk do t'i eliminojmë shkaqet që sollën dhunën e fundit," tha Ivanoviq.

Ai e konsideron këtë si një prej parakushteve kryesore për krijimin e ambientit në të cilin do të jetë e mundur të rivendoset besimi i serbëve në bashkësinë ndërkombëtare dhe shqiptarët në Kosovë.

"Nga një qasje e tillë do të përfitonin gjithashtu edhe shqiptarët, sepse në këtë mënyrë ata do ta lironin veten nga barra e nacionalizmit, i cili sigurisht se nuk është në interesin e tyre. Në fund, nga kjo do të përfitonte gjithashtu edhe bashkësia ndërkombëtare, sepse me eliminimin e ekstremistëve ata do të kishin



Ndërtesë e shkatërruar në Lipjan më 18 mars

rast për rënjosjen e standardeve demokratike dhe vlerave europiane midis banorëve në Kosovë," vlerëson Ivanoviq.

Përfaqësuesit e koalicionit "Kthimi" theksojnë se ende ka shpresë për një lloj jetese të përbashkët të serbëve dhe shqiptarëve, dhe se kjo varet vetëm nga mënyra në të cilën bashkësia ndërkombëtare do t'i sanksionojë të gjithë ata që janë përgjegjës për dhunën e marsit.

Bogolub Millosheviq, anëtar i koalicionit "Kthimi" nga Kamenica, thotë se me 17 dhe 18 mars në Kamenicë dhe fshatërat përreth kishte pak dhunë.

"Këtu nuk kishte vrasje apo djegie të shtëpiave, por kishte përpjekje që të gjitha këto të bëhen. Mendoj se dallimi është [në Kamenicë] se ekziston një lloj i jetesës shumënike. Ka ende shumë serbë që jetojnë këtu, ndërsa shqiptarët dhe serbët kanë një mentalitet tjetër,

më të qetë, jo aq agresiv si në zonat tjera. Gjithashtu, KFOR-i amerikan e mori përgjegjësinë e vet për mbrojtjen e serbëve dhe të pronës së tyre shumë me seriozitet," vuri në dukje Millosheviq.

Një ndër problemet më të mëdha për banorët serbë gjatë trazirave të marsit ishte mungesa e komunikimit medial në tërë Kosovën. Për këtë arsye në disa zona të izoluara politikanët serbë nuk mundën të reagojnë në mënyrë adekuate.

"Në Mitrovicë politikanët ishin të organizuar më mirë dhe kishin qasje më të mirë në informata dhe media. Në vendet tjera, posaçërisht në enklavat e izoluara, politikanët nuk ishin në gjendje të jenë në nivel me situatën kështu që reagimet e tyre ishin më pak adekuate. Ne në Kamenicë vërtetë ishim në errësirë informative dhe reagimet e politikanëve, nëse kishte pasur ndonjë, nuk mund

të arrinin deri te publiku," beson Bogolub Millosheviq. Ai gjithashtu kishte përshtypjen se, fatkeqësisht, publiku i gjerë në Serbi nuk brengoset shumë për situatën në Kosovë.

Në anën tjetër, Nenad Radosavleviq, këshilltar i PSSP-së të KB-ve për kthimin, thekson faktin se ngjarjet e marsit arritën t'i bashkojnë të gjithë politikanët serbë në Kosovë, ndonëse pas disa ditësh shenjat e përçarjeve ndërmjet tyre u bënë të dukshme. Motivi themelor për përçarje në këtë moment, sipas Radosavleviqit, është se individët do të dëshironin të sigurojnë pozicione më të mira për bisedimet në të ardhmen.

"Disa politikanë serbë tani po bëjnë çmos duke u munduar ta imponojnë veten para bashkësisë ndërkombëtare si negociatorë kyç. Për këtë qëllim ata po përpiqen që ta përfitojnë përkrahjen e Beogradit dhe vetë Prishtinës," vlerësoi Rado-

savleviq, duke mos i përmendur politikanët për të cilët po mendonte.

Kishte shumë kritika për punën e misionit civil në Kosovë, veçanërisht pas valës së dhunës në mars. Siç duket kjo është pika për të cilën janë dakord si serbët ashtu edhe shqiptarët.

“Unë mendoj se UNMIK-u është definitivisht i vdekur pas kësaj. Ne në vazhdimësi përkujtoheshim se pika më e dobët e UNMIK-ut është sjellja e vet pasive dhe pavendosmëria nga frika prej reagimeve të shumicës shqiptare,” mendon Bogolub Millosheviq. Duke e plotësuar, Nenad Radosavleviq mendon se përbrenda UNMIK-ut ka indiferencë të thellë individuale ndaj qasjeve serioze për zgjidhjen e problemeve.

Në anën tjetër, asnjë institucion i Kosovës nuk meriton notë pozitive lidhur me ngjarjet e marsit.

“Edhe në rast se këto institucione nuk mund të mbahen përgjegjëse për dhunën, është e qartë se ato mund të jenë përgjegjëse për krijimin e kushteve që e shkaktojnë dhunën. Këto institucione kanë toleruar një atmosferë të tillë të urrejtjes ndëretnike, duke shkuar deri në pikën kur situata nuk mund të kontrollohej më. Fatkeqësisht, disa udhëheqës shqiptarë të Kosovës as që deshën të bënin diçka për ta kontrolluar situatën,” tha Radosavleviq.

“Unë nuk e kam përshtypjen se dikush sinqerisht i kundërshtoi të gjithat që ndodhën në mars. Edhe tani gjatë përpjekjeve fillestare për rindërtimin e shtëpive, ata janë duke u përpjekur për ta parandaluar në ndonjë farë mënyre,” vlerëson Millosheviq.

Pas 17 marsit, ekziston një bindje e fortë në mesin e serbëve të Kosovës se dhuna ishte përgatitur dhe organizuar mirë dhe se udhëheqësit politikë të nivelit qendror dhe lokal, kanë përgjegjësi të plotë për atë që



Mitrovica më 17 mars

ndodhi – nëse ata nuk janë nxitës të drejtpërdrejtë, ata janë fajtorë së paku për faktin se nuk kanë bërë asgjë për ta ndaluar këtë dhunë.

Bogolub Millosheviq beson se përbrenda komunitetit shqiptar, dhe posaçërisht në nivelet politike, ka një qëndrim unik ndaj serbëve, gjë që është një prej pengesave kryesore për vazhdimin e proceseve demokratike në Kosovë.

Nenad Radosavleviq pajtohet dhe vëren se gjatë disa viteve të fundit në Kosovë është bërë fare pak për vendosjen e dialogut dhe besimit midis komuniteteve.

Në disa pjesë të Kosovës ende ka vullnet për kontakte ndërmjet komuniteteve. Bogolub Millosheviq thotë se në Kamenicë shqiptarët po përpiqen të fillojnë një dialog me serbët, mirëpo hendeuku i mosbesimit ndërmjet komuniteteve është ende i thellë.

“Kamenica është specifike në këtë aspekt. Tani shqiptarët po përpiqen mjaft shumë për ta përmirësuar situatën dhe për

të thënë se ajo që ndodhi, nuk do të përsëritet kurrë më, por askush nuk u beson atyre, sepse ne u besuam atyre tërësisht për pesë vite. Unë mendoj se ata do të dëshironin t’i minimizonin të gjitha që ndodhën. Unë kisha më shumë takime me shqiptarët në nivel lokal dhe ky është rrëfimi klasik i tyre – përderisa ju jeni aty ata të gjithë i dënojnë këto ngjarje, megjithatë kur e shohin se janë të rrethuar me shqiptarë të tjerë, ata heshtin ose rropaten të mbrojnë ose arsyetojnë veprimet e ndonjë kapadahu i cili ka vrarë, shkatërruar ose djegur shtëpi,” mendon Millosheviq.

Do të ishte gabim i papërmirësueshëm nëse ngjarjet e marsit harrohen dhe heshten, pa u ballafaquar me të vërtetën e plotë në mënyrë të hapur dhe me guxim. Përndryshe askush në Kosovë nuk do të mund të ndërtojë një të ardhme të bazuar në vlera të shëndosha, pajtohen që të gjithë bashkëbiseduesit tonë.

“Pas 17 marsit Kosova përfundimisht nuk është e njëjta me atë që ishte më parë dhe nëse

dëshirojmë të ndërtojmë shoqëri demokratike këtu, atëherë e tërë politika deri më sot duhet të rivlerësohet plotësisht,” deklaroi Oliver Ivanoviq.

Është pikëpyetje nëse udhëheqësit politik shqiptarë në këtë moment janë të gatshëm dhe të aftë për një konfrontim të tillë, duke pasur parasysh se në fund të këtij viti në Kosovë do të mbahen zgjedhjet dhe ka shumë që frikohen se çfarëdo politike ndryshe nga kjo do të rezultonte me numër më të vogël të votave në këto zgjedhje, thotë Nenad Radosavleviq.

Megjithatë, nëse nuk ka energji dhe gatishmëri në qarqet e bashkësisë ndërkombëtare për rifillimin e procesit demokratik në një mënyrë shumë të vendosur dhe serioze, gjasat janë të vogla që koalicioni “Kthimi” të kthehet në Kuvend, por ç’është më me rëndësi – procesi i kthimit dhe rivendosjes së besimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve sigurisht se do të humbet për këto gjenerata, beson Oliver Ivanoviq.

UNMIKU dhe Institucionet e Kosovës, gjetja e rrugës së mbarë drejt partneritetit

Ilir Deda, Zyra e Kryeministrit

Partneriteti. Një koncept ky i përmendur dendur që nga fundi i vitit të shkuar, i riaktualizuar nga PSSP Holkeri dhe i kërkuar nga UNMIKU/Institucionet e Përkohshme të Kosovës (IPVQ-ët) për më tepër se dy vite. Kështu, hapi i parë, në drejtim të krijimit të partneritetit ndërmjet administratës ndërkombëtare dhe institucioneve vendore, u hodh me krijimin e pesë grupeve të përbashkëta të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve për vënien në jetë të standardeve. Protestat e dhunshme të 17 dhe 18 Marsit, të cilat i tronditën dhe tmerruan si UNMIK-un ashtu edhe IPVQ-ët, provuan se partneriteti i mirëfillët ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe administratës së KB-ve është i domosdoshëm. Është e udhës të thuhet, se nuk mjafton që vetëm të theksohet se duhet ndërtuar një partneritet të njëmendët, ngase kjo kërkon punë serioze. Megjithatë, ngjarjet e fundit tregojnë se janë duke u bërë përpjekje, që të krijohet një partneritet, i cili është më se i domosdoshëm.

Përparimi i ngadalshëm në çështjet e sigurisë dhe të zhvillimit ekonomik ka shkaktuar frustracione tek popullata. Ndaj, kosovarëve nuk u kishte mbetur tjetër pos të shikonin heshturazi "fajësimin në formën e lojës së ping-pongut" në mes të ndërkombëtarëve dhe vendorëve. Ndërkaq, vetëm pas ngjarjeve të muajit Mars ata filluan të dëgjojnë thirrjet që u drejtoheshin të dy organeve ekzekutive për nevojën e menjëhershme për ndryshime. Së këndejmi, katandisja e tërë Kosovës në kaos dhe infiltrimi i ekstremitëve për t'u vënë në ballë të popullatës së pakënaqur, ishte thirrja e fundit drejtuar si

UNMIK-ut ashtu edhe IPVQ-ve që të përqëndrohen në problemet reale me të cilët Kosova është duke u përballur. Ato janë: ekonomia e dobët, siguria dhe marrëdhëniet e brishta ndër-etnike – pas shpërthimit të dhunës, inekzistente.

Me këtë rast, duhet vënë në dukje se kuadri i tanishëm ligjor i parashikuar me Kornizë Kushtetuese është një faktor që pengon krijimin e raporteve vërtetë të barabarta në mes të UNMIK-ut dhe kosovarëve. Kështu, Korniza Kushtetuese në të vërtetë e vë Qeverinë në pozitën e vartësit karshi UNMIK-ut, duke i ndarë përgjegjësitë në sferën ekzekutive në shpërputhje me situatën aktuale në Kosovë. Së këndejmi, që kur u themeluan institucionet e Kosovës, të cilët u kompletuan në mars të vitit 2002, kosovarët njëzëri kanë kërkuar transferimin e sa më shumë kompetencave nga fusha ekezekutive. Mirëpo, kjo ka shkaktuar tensione me UNMIK-un. Ndaj, dhe thirrjet si nga PSSP-ja ashtu edhe nga liderët politikë dhe institucionalë, do të jetë vështirë të realizohen me kuadrin ekzistues ligjor. UNMIK-u kërkon garancione shtesë nga Qeveria se ajo do të jetë në gjendje për të qeverisur dhe me të drejtë i referohet në rezultatet e pakënaqëshme në fushat e "transferuara" në arsim dhe shëndetësi. Megjithatë, kjo nuk mund ta zvogëlojë nevojën për bartje të mëtejshme të kompetencave. Situata aktuale në këto dy sfera nuk është rezultat i jokompetencës së palës kosovare, por më parë është pasojë e një situatë të trashëguar për më shumë se një dekadë: trashëgimia dhe kolapsi i sistemit komunist, shtypja institucionale, sistemi paralel, konflikti i armatosur

dhe mungesa e kapaciteteve është rrjedhojë e të gjithë këtyre faktorëve. Insistimi i kosovarëve për më shumë përgjegjësi në sistemin gjyqësor dhe polici, është njëherazi edhe kërkesë për shtimin e kredibilitetit të këtyre dy institucioneve, të cilët gjatë kohës së komunizmit dhe gjatë viteve të nëntëdhjeta, u përdorën si mekanizma të dhunës. Ndërsa, refuzimi nga ana e UNMIK-ut për të fuqizuar kapacitetet kosovare në këto fusha është duke rënë. Hapja e gjashtë zyrave të reja në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) është një shenjë mjaft inkurajuese, e cila dëshmon jo vetëm që Kosova është duke përparuar, por edhe se partneriteti dalngadalë ka filluar të formohet. Zyrat që do të hapen janë: Zyra për Ko-ordinim të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe për Dialog Rajonal, Zyra për Integritim Evropian, Zyra për Siguri Publike, Zyra për Energjetikë, Zyra për Çështje Juridike si Planifikimin e Politikave Strategjike si dhe Zyra për Planifikim. Qëllimi i këtyre zyrave është që t'i fuqizojë kapacitetet e kosovarëve në fushat e rezervuara.

Largimi i kreut të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-së) znj. Marie Fuqi dhe përparimi i punës rreth hapjes së zyrave janë shenja mjaft shpresdhënëse. Procesi i privatizimit duhet të rifillojë sa më shpejtë që është e mundur, me që do të përputhej me uljen e tatimeve për repromaterialet bujqësore. Nga ana tjetër, Qeveria ka treguar



Ilir Deda

pjekuri me reagimin e saj ndaj dhunës dhe ka qenë mjaft aktive gjatë krijimit të Komisionit Qendror Ndërmintor për të menaxhuar fondet e caktuara për rindëtimin e shtëpive, kishave ortodokse dhe manastireve të dëmtuara dhe të shkatërruara. Për më tepër, Qeveria është zotuar se do të angazhohet edhe në rindëtimin e urave ndërmjet komuniteteve etnike të Kosovës, veçanërisht ato me sërëbët dhe ashkalitë e Kosovës. Prandaj, IPVQ-ët duhet të demonstrojnë seriozitetin e tyre lidhur me këto çështje duke kaluar në veprime konkrete.

IPVQ-ët dhe UNMIK-u do të punojnë së bashku në implementimin e standardeve për Kosovën, të cilat do t'ia bëjnë të mundur Kosovës që të jetë më afër përmbushjes së standardeve evropiane, demokratike. Në këtë kuptim, si UNMIK-u ashtu edhe IPVQ-ët duhet të jenë më të përgjegjshëm dhe të tregojnë më tepër gatishmëri për partneritet, në mënyrë që dhuna që shpërtheu gjatë muajit Mars të mos përsëritet.

Zhvillimi i Potencialit Bujqësor të Kosovës

Intervistë me z. Tomë Hajdaraj, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimin Rural

Shpresa Mulliqi, OSBE

Zoti Tomë, a mund të na thoni se cilat janë aktivitetet kryesore të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimin Rural të Kuvendit të Kosovës?

Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimin Rural duhet t'i shqyrtojë afro trembëdhjetë ligje të lëmive të ndryshme që kanë të bëjnë me këtë ministri dhe me këtë komision parlamentar – është fjala për ligjet për blegtori, veterinari, toka bujqësore, ujitje, cilësi të ushqimit, inspeksione, etj. Njëherazi, ky komision ka paraparë edhe kontakte me institucione të tjera në Kosovë dhe jashtë Kosovës, jo vetëm për zhvillimin e ideve, shkëmbimin e përvojave, por edhe për realizimin e projekteve të përbashkëta. Fjala vjen, gjatë këtij viti komisioni ynë ka bërë një vizitë edhe në Parlamentin e Bosnjë Hercegovinës, meqë ky shtet është duke u përballur me probleme të transitionit. Ndaj dhe kemi vlerësuar se përvojat e kolegëve boshnjakë do të jenë të dobishme për ne, si kur është fjala për hartimin e ligjeve, ashtu edhe për mbikëqyrjen e implementimit të ligjeve dhe akteve të tjera ligjore.

Në programin e punës, komisioni poashtu ka paraparë që të bëjë një vizitë edhe në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë. Kohë më parë, komisioni simotër i Parlamentit të Shqipërisë e ka vizituar komisionin tonë dhe këtij takimi jashtëzakonisht të frytshëm, i ka paraprirë nënshkrimin i marrëveshjes për tregëti të lirë, veçanërisht në sferën e ushqimit, ndonëse nuk jemi të kënaqur me dinamikën e implementimit të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, pas takimit dhe bisedave që kemi pasur këtu me përfaqësuesin e Zyrës së Bullgarisë në Prishtinë, zotin Kolev, ne kemi bërë një propozim që, diku pranverën e këtij viti, një dërgatë e këtij komisioni ta vizitojë Bullgarinë. Dihet se tregëti me Bullgarinë, sidomos me ushqime dhe reprovateriale, ka filluar të lulëzojë.



Tomë Hajdaraj

Përpos kësaj, komisioni ynë ka parashikuar në programin e tij që të bëjë vizita në 15 kuvende komunale, ngase dihet mirëfilli se bujqësia është njëra ndër çështjet më të rëndësishme për Kosovën. Ndërkaq, nga takimet që kemi realizuar me kryetarët e komunave, me drejtorët e drejtorateve për bujqësi dhe kryeshefat e ekzekutivit të komunave që i kemi vizituar deri më tani, kemi konkluduar se marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë dhe kuvendeve komunale janë të dobëta. Prandaj, lipset që këto marrëdhënie të përmirësohen.

Sa ligje janë duke u zbatuar dhe si mund të mësojë qytetari për vënjen në jetë të ndonjë ligji të caktuar?

Fatkeqësisht duhet konstatuar ne nuk jemi gjithnjë edhe aq të kënaqur me mënyrën se si implementohen ligjet e miratuara nga Kuvendi dhe nga instancat tjera të pushtetit, sidomos në nivelin komunal. Prandaj, një prej arsyeve pse kemi vendosur që t'i zhvillojmë këto takime nëpër komuna është edhe diskutimi i çështjes së aplikueshmërisë dhe zbatimit të ligjeve në nivelin komunal. Unë besoj se në një të ardhme do t'i thërrasim sërish në takime të gjithë drejtorët e drejtorateve përkatëse si dhe përfaqësuesit e ministrisë për të diskutuar së bashku lidhur me këto çështje.

Ne jemi përgjegjës edhe për tokën që është në pronë shoqërore, që përbëhet prej mbi 187 mijë hektarë pyje dhe mbi 70 mijë

hektarë të tokës së bukës, të cilat nuk janë të menaxhuara pothuajse fare. Mirëpo, tani jemi duke bërë përqapje që t'i bëjmë bashkë kuvendet komunale dhe ministrinë përkatëse për të diskutuar në hollësi zbatimin e ligjeve.

Problemi kryesor këtu është çështja e pronësisë apo thënë më mirë si ta privatizojmë pronën që ka më shumë se pesë pronarë? Ne kemi një propozim konkret për këto prona: krijimin e një fondi për pyjet dhe tokat bujqësore në pronësi shoqërore që do të menaxhohet nga Qeveria e Kosovës apo nga PSSP-ja, nëse është e drejtë e rezervuar, por jo të ngutemi me procesin e privatizimit të kësaj pasurie. Me këtë rast, duhet theksuar edhe njëherë se toka është një ndër çështjet më fundamentale për ekzistencën e një shoqërie dhe të një shteti në tërësi, ndaj dhe tendencat për privatizim të nxituar janë të papranueshme. Unë kujtoj se ne do t'ia dalim mbanë ta ruajmë gjendjen e tanishme derisa të mos e gjejmë pronarin e vërtetë të saj. Të mendosh se e tëra kjo mund të bëhet me përpikëri dhe pa dhimbje, vetëm përmes një agjencie siç është AKM-ja, për mendimin tim, përbën një nonsense.

S'do mend se të gjitha ligjet diskriminuese duhet të shfuqizohen dhe në vend të tyre të fillohet me zbatimin e ligjeve të reja sa më parë që të jetë e mundur për t'u përshtatur standardeve të Unionit Evropian. Kjo është edhe arsyeja përse UNMIK-u është këtu.

Zoti Hajdaraj, është e qartë se në Kosovë ka një sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore, të cilat kanë ngelur të papunuara. A mendoni se këto djerrina të shumta janë pasojë e mungesës së pronarëve të ligjshëm të tokave, apo mbase e paaftësisë së strukturave aktuale për menaxhimin e drejtë të tyre?

Në Kosovë ekzistojnë tri lloj pronash shoqërore: tokat bujqësore në pronësi shoqërore, tokat e tjera

në pronësi shoqërore dhe të mirat e përbashkëta, siç janë quajtur "utrinët". Kështu, në kategorinë e tretë bëjnë pjesë pronat siç janë ta zëmë bleshkët, për të cilat ekzistojnë tapitë adekuate, është pra dokumentacioni, por të cilat i ka shfrytëzuar i tërë një fshat si pronë të përbashkët

Bujqësia dhe blegtoria thuhet se shkojnë krahpërkrah me njëra tjetrën. Cila është aktualisht pozita e blegtorëve?

E them me dhëmbshurinë më të madhe se pas faktorit njeri, në dhjetë vjetët e fundit dhe në luftë, Kosova më së shumeti e ka pësuar në lëmin e blegtorisë. Para tre katër vjetësh, një grup i ekspertëve ka bërë një analizë, me ç'rast ka vlerësuar se dëmet që i janë shkaktuar blegtorisë gjatë dhjetë viteve të shkuara, kapin shuma prej miliarda markash (DM). Dhe, mu për këtë arsye, ne kemi insistuar që Ministria e Bujqësisë të përgatisë një projekt në të cilin do të bëhej vlerësimi i dëmeve të luftës, në toka bujqësore, pyje, kullosa, e në veçanti në blegtori. Ngase, dihet mirëfilli se mbi 65 % të fondit të gjithëmbarsuem blegtoral është shkatërruar. Ne si komision parlamentar kemi kërkuar nga Këshilli Ekonomik Fiskal, madje që në vitin e kaluar, që të bëjë ndryshime lidhur me taksimin e lëndëve të para, përfshirë këtu edhe kafshët e gjalla, por fatkeqësisht akoma nuk ia kemi dalur mbanë. Deri më tani një gjë të tillë kemi arritur ta bëjmë vetëm për farërat dhe drithërat e bardha, por për fat të keq në vend se të përfitonte qytetari ynë, në këtë rast më shumë përfituan prodhuesit e miellit. Por, ne nuk e kemi ndërmend që të rrijmë duarkryq as këtë vit dhe prandaj kërkojmë nga Drejtoria për Politikë dhe Zhvillim, pranë Ministrisë së Bujqësisë, që të hartojë objektivat, prioritetet dhe brenda mundësimet krijimin e një fondi për zhvillimin e bujqësisë. Shpresoj së kësaj radhe do t'ia dalim mbanë.

Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës reagon lidhur me ngjarjet e marsit

Ky artikull është shkruar më se dy javë pas dhunës në shkollë të gjerë, ndaj njerëzve dhe pronës që ndodhi në Kosovë me 17-18 mars, 2004. Prandaj, është paraparë që gjatë muajve të ardhshëm të bëhet një analizë e hollësishme nga Policia Civile e UNMIK-ut në mënyrë që bashkë me rekomandimet të nxjerren përfundime. Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) është duke bërë mbledhjen fakteve lidhur me identifikimin e zbrastësive eventuale në trajnimin e policëve.

Tim Wilson, *Shef i Planifikimit, SHSHPK*
Departamenti i Edukimit dhe Zhvillimit të Policisë

Është me rëndësi të kemi parasysh se shumë policë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) i rrezikuan jetën e tyre dhe u plagosën në krye të detyrës ndërsa ballafaqoheshin me të papriturat e hidhura. Shumë të tjerë i kryen detyrat e tyre ashtu si ditën më së miri. Megjithatë, janë duke u zhvilluar hetimet lidhur me disa gjoja se akte kriminale apo shpërdorime të detyrës nga një numër i vogël policësh të SHPK-së dhe nëse ndonjë rast vërtetohet, atëherë do të marrën masa adekuat kundër tyre. Ndonjëherë është shumë më lehtë të fajsohen njerëzit me uniforma se sa individi kur bëhen akuza për abuzime.

Në natën e të enjtes me 18 mars 2004, unë personalisht kam qenë dëshmitar i përkushtimit dhe trimërisë së policëve dhe instruktorëve tanë të SHPK-së të Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës. Për arsye ende të panjohura, një grup prej më se njëmijë vetash u përqëndruan tek komuniteti lokal ashkali mu aty pranë stacionit policor dhe shkollës sonë. Shumë prej shtëpive të tyre u sulmuan, u plaçkitën dhe u dogjën nga kriminelët të cilët fshiheshin në mesin e turmës. Personeli ynë i SHPK-së u ndihmoi disa policëve të SHPK-së në detyrë në stacionin policor për t'i përcjellur mbi dyqind burra, gra dhe fëmijë ashkali deri në vend të sigurt. Fillimisht ata u dërguan në stacionin policor dhe më pas në shkollën tonë pasi

që e bëmë një vrimë në rrethojën e hekurt të vendosur ndërmjet stacionit policor dhe SHSHPK-së. Ndonëse policët e SHSHPK-së tanimë kishin pasur një ditë të plotë trajnimi në shkollë, ajo që bënë është ajo që pritej nga policët, duke rrezikuar me këtë rast sigurinë individuale, mirëqenien ose brengosjen për familjet e tyre.

Nga SHPK-ja është pritur dhe kërkuar që të aftësohet shumë shpejt dhe mbase më shpejtë se nga çdo shërbim tjetër i tillë në botë. Këtu e kam fjalën jo vetëm për personelin por edhe për shkathhtësinë e tyre që po arrinë në një nivel të lakmueshëm me një shpejtësi aq sa lejon buxheti dhe koha. Afër mendsh se nuk janë përmbushur të gjitha detyrat dhe prandaj deri para dy javësh prioritetet për ta përmbushur detyrën dukeshin se janë të mjaftueshme. Mirëpo, tani është e qartë se disa prej këtyre prioritetëve duhet të ndryshohen dhe përshtaten që në të ardhmen të jemi të jemi të gatshëm për t'u përballuar me sulme të planifikuara dhe organizuara kundër disa komuniteteve në Kosovë, si dyshohet se ishte rasti muajin e kaluar. Fjala vjen, një nga mënyrat për të realizuar këtë është zhvillimi i qendrës së komandës dhe kontrollit me qëllim të një bashkërenditje më të efektshme dhe më të shpejtë të kuadrove të SHPK-së në tërë Kosovën. Kështu, jemi duke punuar në përzgjedhjen e pajisjeve të nevojshme, me-



Trajnimi në Shkollën e SHPK-së në Vushtrri

që kjo është një ndërmarrje e kushtueshme që kërkon planifikim të kujdesshëm. Vlen të theksohet, se para ngjarjeve të fundit, SHPK-ja nuk kishte shumë nevojë për t'i përdorur të gjitha resurset e saja për t'u përballur me të gjitha incidentet e orkestruara të trazirave në tërë rajonin. Por, tani duhet që këto boshllëqe urgjentisht të plotësohen.

Duhet vënë në dukje se secili polic i SHPK-së në fazat e hershme të trajnimit ka pasur shumë orë mësimi mbi të drejtat e njeriut, Kodin e mirësjelljes dhe sjelljen etike. Është e vërtetë se gjenerata e tashme e kadetëve është e para që ka mbajtur 20 javë trajnim themelor. Megjithatë, materiali i kursit do të rishqyrtohet për të parë se çfarë përmirësime të mëturshme mund të bëhen në dritën e ngjarjeve të fundit.

Ruajtja e paqes është përgjegjësi e secilit e jo vetëm e policisë. SHSHPK u ka mësuar kadetëve konceptet dhe praktikat demokratike të sjelljes së policisë dhe njëherësh si SHPK-ja ashtu edhe Policia e UNMIK-ut, kanë një ekip aktiv të policisë në bashkësi, i cili e promovon partneritetin e policisë me liderët e bashkësive dhe shkollat. Autoritetet vendore dhe ndërkombëtare inkurajohen të punojnë me policinë e tyre vendore në të gjitha nivelet me qëllim që të avancojnë këtë partneritet dhe t'i ndajnë përgjegjësitë sa i takon respektimit të ligjit dhe rendit brenda komunitetit. Së këndejmi, duhet mbajtur takime të rregullta publike me liderët e komuniteteve dhe policinë për të dëgjuar dhe ku ka mundësi edhe për t'u ndihmuar të gjithë njerëzve që i përfaqësojnë ata.

Reforma e sistemit arsimor që duhet të arrijë tek nxënësit

Në fillim të këtij shekulli të ri, ne si kosovarë, jetojmë në një kohë të transformimeve të shpejta. Pothuajse çdo aspekt i jetës tonë po ndryshon, duke filluar që nga marrëdhëniet në familje e deri në marrëdhëniet me shoqërinë në vend, rajon dhe më gjërë. Kosova dhe banorët e saj duhet të jenë të përkushtuar që arsimit të jetë çështje për të gjithë e jo vetëm e institucioneve të kësaj shoqërie. Ndryshimet që i bëjmë sot dhe çdo ditë që vjen do të kenë rezultate afatgjate.

Venera Lllunji, këshilltare politike

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Qëllimi kryesor i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është të sigurojë arsimim më të mirë për të gjithë. Nuk mund të thuhet se ndodh diçka në arsim poqese nuk arrin te nxënësi. Së këndejmi, për të siguruar se reforma vërtetë do të arrijë te nxënësi, MASHT-i synon:

- sistem unik të arsimit: Unifikimi i sistemit të arsimit kërkon zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera. Në vitin 2003 Kuvendi i Kosovës miratoi dy ligje për arsim: Ligjin për arsim fillor dhe të mesëm dhe Ligjin për arsim të lartë;

- të sigurojë hapësirë të mjaftueshme në shkolla duke respektuar nevojat për nxënie dhe për mësimdhënie, siguri dhe ambient të shëndoshë;

- të ofrojë mundësi për zhvillim mendor, shpirtëror e psikofizik për të gjithë, përfshirë këtu shkollimin për të gjithë, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve shkollore si dhe rishikimin e tyre me qëllim të sigurimit të nivelit të lartë të cilësisë së tyre në përputhje me standardet evropiane. Deri më tani janë përpiluar dhe përkthyer plan-programet mësimore për klasët 1,6,7,9,10 dhe 11, nga grupe ekspertësh edhe në gjuhët e komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë. Komuniteti serb nuk tregon gatishmëri që të integrohet në këto rrjedha, prandaj edhe ka vështirësi në kompletimin e grupeve të ekspertëve lëndorë. Megjithatë, një grup ekspertësh serb po bën vlerësimin e plan-programeve

në gjuhën serbe, ndonse ende nuk e ka dhënë mendimin, respektivisht pëlqimin e vet. UNMIK-u dhe ekspertë të Këshillit të Evropës janë duke bërë vlerësimin e teksteve shkollore të historisë në gjuhën shqipe dhe serbe;

- MASHT përpiqet të inkurajojë dhe përfshijë prindërit dhe komunitetin në përgjithësi, në përkrahje të ndryshimeve në sistemin e arsimit, me ç'rast, transparenca dhe korrektësia me opinionin e gjërë dhe me mediat për të arriturat dhe/apo vështirësitë me të cilat mund të ballafaqohet sistemi i arsimit në rrugën e saj të zhvillimit, nuk do të mungojnë.

- Pikësynimi kryesor në procesin e reformimit të arsimit të lartë është të investohet në gjenerata të cilat do të shkollohen sipas standardeve evropiane. Universiteti do të zhvillohet si institucion me nisma të reja, risi, pjesëmarrje aktive në rrjeta universitare dhe bashkëpunim me insitucione të arsimit të lartë të vendeve tjera, institucion me orientim kah tregu me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të shoqërisë. Departamentet në Universitet janë të inkurajuara të zhvillojnë plan-programe të reja sipas kërkesave të tregut, të promovojnë metodologji bashkëkohore të mësimdhënies, të bëjnë trajnimin e ligjëruesve apo mësimdhënësve, të sigurojnë dhe mbajnë partneritet me universitetet tjera në rajon, Evropë, e më gjërë.

MASHT ka bashkëpunim mjaft të mirë dhe korrekt më bashkësinë ndërkombëtare, me për-

faqësuesit e UNMIK-ut dhe me organizata të qeverive të ndryshme të cilat veprojnë në Kosovë. Organizatat ndërkombëtare kanë ndihmuar shumë me projektet e tyre në rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë. Me këtë rast, do të përmendur bashkëpunimin me: Bankën Botërore, CIDA-n kanadeze, KEDP, UNICEF, GTZ, Grupin Përkrahës të Finlandës (Finish Support Group), Swiss Contact, AER dhe organizata tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

Të gjitha këto veprimtari të sipërpërmendura dhe shumë të tjera tregojnë se arsimit apo shkollimi në Kosovë po ecën me hapa të sigurtë drejt zhvillimit dhe përparimit. MASHT dhe zyrtarët e saj e kuptojnë dhe çmojnë lartë vlerën që e ka arsimit për tërë shoqërinë kosovare. Edhe vet Qeveria e Kosovës e konsideron arsimin si prioritet, si çështje esenciale për zhvillim të mirëfilltë të mbarë Kosovës.

Ngjarjet e datës 17 dhe 18 mars i tronditën të gjithë. Manifestimi i dhunës ishte i papritur dhe i paparashikueshëm. Situata

eskaloj nga një revoltë dhe dhimbje e shprehur - nga ana e popullatës shumicë për vdekjen e tmerrshme të tre fëmijëve në Çabër- në një ngjarje agresive dhe të dhunshme, e cila dëmtoi imazhin e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndërmarrë një varg aktiviteteve ato ditë për uljen e tensioneve dhe për përmbytjen e nxënësve nga dalja në rrugë dhe rrezikimi i jetës së tyre. Janë mbajtur konferenca për shtyp ku është bërë apel që mësimdhënësit, drejtorët e shkollave dhe sidomos prindërit të mos i lejojnë fëmijët e tyre të dalin në rrugë dhe të bashkohen me turmën e demonstrantëve. Njëherësh, MASHT si pjesë e Qeverisë së Kosovës do t'a jep edhe kontributin e vet në riparimin e dëmeve që janë shkaktuar gjatë atyre ditëve. Ne shpresojmë se këto ngjarje nuk do të shënohen dhe mbahen në mend si njollë e zezë e Kosovës dhe se bashkësia ndërkombëtare në bashkëpunim me kosovarët, do të punojnë për një të ardhme më të mirë.



OSBE-ja lehtëson ndërtimin e kapaciteteve për grupin parlamentar "Komunitetet tjera"

Senad Saboviq, OSBE

Ekipi Përkrahës i Qeverisjes Qendrore (CGST) i Departamentit të Demokratizimit pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë organizoi një seminar mbi ndërtimin e kapaciteteve për grupin parlamentar "Komunitetet e tjera" (OC) në Ohër. Ngjarja, e cila u zhvillua prej 11 deri më 14 mars të vitit 2004, ishte një rast unik për anëtarët e grupit të shkëputen nga bregat e përditshme dhe t'u rreken problemeve të tyre në mënyrë analitike. Ekipi për Përkrahje Qeverisjes Qendrore (CGST) pjesërisht është përqëndruar edhe në aftësimin dhe trajnimin e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës, dhe veç kësaj, ne u kemi ofruar ndihmë të vazhdueshme edhe partive minoritare të këtij Kuvendi. Në këtë kontekst, ne e pamë të udhës që të organizojmë një seminar, i cili do t'u ndihmonte anëtarëve të grupit "Komunitetet tjera", për ta përmirësuar mënyrën e konceptimit të të drejtave të minoriteteve, si dhe që të krijojnë një frymë kompromisi midis tyre, në mënyrë që ata të marrin qëndrime të përbashkëta mbi çështjet që mund të kenë ndikim në komunitetet e tyre. Këto dy komponente ishin përcaktuar si dy qëllime kryesore të kësaj ngjarjeje, ngaqë ato kanë të bëjnë me dy nevojat më të rëndësishme të këtij grupi parlamentar: konceptet mbi të drejtat e minoriteteve, në përgjithësi dhe konsolidimi i aktivitetit politik, në veçanti.

Të dy ekspertët ndërkombëtarë të drejtave të njeriut vërtetë i kishin përvetësuar këto dy çështje që diskutoheshin, ndaj dhe ishin ftuar për të shkëmbyer njohurit dhe dijet e tyre me pjesëmarrësit



Grupi parlamentar "Komunitetet tjera" në Ohër

dhe që t'i lehtësojnë diskutimet e planifikuara. Vërtetë, përveç përvojës së tyre profesionale për të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, që të dy ekspertët, Gregori Fabian, i cili kishte punuar më parë në Departamentin për të Drejtat e Njeriut në Misionin e OSBE-së në Kosovë, dhe Klaiv Bolldvin, nga Grupi Ndërkombëtar për të drejtat e minoriteteve, njëherësh janë edhe njohës të mirë të problemeve të caktuara që kanë të bëjnë me jetën e minoriteteve në Kosovë: në vitet e mëparshme që të dytë ishin të përfshirë në procesin e monitorimit të gjendjes së minoriteteve etnike në Kosovë dhe në hartimin e raporteve për vlerësimin e minoriteteve të misionit të OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR-së. Modulet që ata i krijuan dhe ligjruan me

ndihmën e anëtarëve të Ekipit Përkrahës të Qeverisjes Qendrore (EPQQ), siguruan një kombinim të shkëlqyeshëm të teorisë për të drejtat e minoriteteve dhe mjeteve të posaçme për avansimin e këtyre të drejtave, të cilat u krijuan për nevojat e veçanta të grupit parlamentar për "Komunitetet tjera". Kështu, në pjesën e parë të seminarit pjesëmarrësve iu ofrua informacioni mbi parimet themelore të të drejtave të minoriteteve, si dhe konventat dhe organizatat ndërkombëtare që merren me to. Në këtë pjesë ligjruerit u përgjigjën në pyetjet si "çka është e drejta" dhe "kush janë minoritetet", por njëherësh prezantuan edhe burimet më të rëndësishme legale ndërkombëtare për këto të drejta dhe institucionet që i mbështesin ato. Përveç

kësaj, pjesëmarrësve u është demonstruar se si zbatohen këta mekanizma në Kosovë dhe si ndërlidhen ato me kontekstin e jetës së minoritarëve në Kosovë.

Pjesa e dytë e seminarit përbëhej nga ushtrimet praktike në të cilat pjesëmarrësit ishin të këshilluar që më parë nga ligjruerit për ta zhvilluar dhe zbatuar metodologjinë analitike ligjore gjatë punës së tyre në Kuvend. Në këto ushtrime, anëtarëve të grupit "Komunitetet tjera" iu dha si detyrë interpretimi i masave relevante ligjore duke u mbështetur në raste të veçanta studimi, duke i identifikuar çështjet ligjore në disa situata të jetës reale, duke e dalluar aspektin politik nga ai ligjor, duke e ndërlidhur këtë çështje me një burim të vetëm të të drejtave, e kështu me radhë. Qëllimi i këtyre ushtrimeve

është që të aftësohen anëtarët e grupit "Komunitetet tjera" që t'i adresojnë çështjet, me të cilat përballen komunitetet e tyre në mënyrë analitike. Arsyet pse u përqëndruan në këto çështje ishin që t'u bëhej e mundur pjesëmarrësve për t'u njohur me mekanizmat praktike, që duhet t'i zbatojnë me rastin e zgjidhjes së çështjeve, të cilat i preokupojnë njerëzit të cilët i përfaqësojnë, si definimi i problemeve dhe identifikimi i çështjeve ligjore, shqyrtimi i mundësive për zgjidhjen e problemit, zhvillimi i planit të veprimit për t'u ballafaquar me çështjen në bazë të elementeve të mëparshme dhe nevojës së përbashkët të komuniteteve të tyre, sikurse edhe zbatimi i këtij plani përmes kanaleve në dispozicion.

Në ditën e fundit, Kryesuesi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadori Paskal Fieski, udhëtoi nga Prishtinën Ohër për ta siguruar edhe një herë grupin parlamentar "Komunitetet tjera" për përkrahjen që Misioni është duke u dhënë jo vetëm atyre si deputetë, por edhe të gjitha komuniteteve të tyre në përgjithësi. Në fjalimin e tij gjatë koktejt me pjesëmarrësit, ligjëruesit dhe personelin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadori Fieski e theksoi veçmazi rëndësinë e funksionimit të konsoliduar dhe koherent të këtij grupi parlamentar.

Së këndejmi, Ekipi Përkrahës i Qeverisjes Qendrore (EPQQ) i Misionit të OSBE-së në Kosovë mund të krenohet me rezultatet që u arritën në të gjitha aspektet që u trajtuan gjatë kësaj ngjarje. Me këtë rast, pjesëmarrësit përpos, që mësuan për mekanizmat e të drejtave të minoriteteve dhe mundësive për zbatimin e tyre në praktikë, ata edhe u kënaqën me bukuritë e qytetit të mrekullueshëm të Ohrit buzë liqenit dhe krijuan marrëdhënie më të afërta ndërmjet tyre.

"Ne e pyesnim veten: cili e ka rradhën?"

Gani Sadik,
kryesues i Grupit Parlamentar "Komunitetet tjera"

Jemi të indinjuar nga ngjarjet e dhunshme të Marsit në Kosovë. Ato ishin të papritura për të gjithë meqë kemi menduar që një dhunë e një shkalle të tillë më kurrë nuk do të ngjajë në Kosovë.

Ndjehemi thellë të pikëlluar për njerëzit që humbën jetërat e tyre – jeta e njeriut është një humbje e pakthyeshme. Dhe përveç kësaj, edhe për veprimet shkatëruese ndaj objekteve me vlerë historike dhe fetare, si një dukuri e paparë në këto troje.

Për ne nga 'Komunitetet tjera', ngjarjet e 17 dhe 18 Marsit ishin të tmerrshme edhe për faktin që shtëpitë e komunitet romë dhe ashkalinjë ishin cak i dhunës. Ndaj, një pyetje logjike do të pasonte pas kësaj: 'kush e ka rradhën tani?'. Fatmirësisht, dhuna nuk u përhap dhe nuk përfshiu edhe 'Komunitetet tjera'.

Ne dënojmë fuqishëm dhunën e shfaqur në Kosovë, dhe gjithë ata që qëndrojnë prapa dhunës i konsiderojmë të jenë keqdashës të Kosovës.

Për pesë vite deri më tani, institucionet së bashku me qytetarët e Kosovës, në sja të ndihmës nga ana e UNMIK-ut dhe KFOR-it janë përpjekur të krijojnë mundësinë që grupe të ndryshme etnike të jetojnë pranë njëri tjetrit në Kosovë. Institucionet kanë bërë shumë përpjekje dhe punë për demokratizimin e Kosovës. Bashkësia Ndërkombtare ka pasur besim tek kosovarët. Fatkeqësisht, çdo gjë mori dhenë dhe u dëmtua.

Jetërat e humbura të njerëzve nuk mund të kthehen. Ka humbur edhe besimi që tërë bota pati tek ne, ndër shumë miq që Kosova ka jashtë. Mbarë bota po flet për ngjarjet tragjike në Kosovë – vallë a ishte kjo ajo që na u desht? Vërtetë, të protestosh dhe të shprehësh revoltën publikisht në mënyrë PA-QËSORE, është parim themelor i demokracisë. Por dhuna nuk në asnjë mënyrë nuk mund të justifikohet.

Për këtë arsye, gjithë njerëzit paqedashës të Kosovës, kanë dënuar dhunën, si institucionet e Kosovës ashtu edhe Kuvendi i Kosovës ndër të parat. Përfaqësuesit nga 'Komunitet tjera' ishin përkrah institucioneve të Kosovës për të dënuar dhunën – ne duhet patjetër ta denojmë dhunën pavarësisht nga vjen ajo. Në veçanti dënojmë dhunën kundër ushtarëve të KFOR-it – misioni i të cilëve është paqeruajtja dhe mbrojtja e qytetarëve të Kosovës. Në anën tjetër, ne përkrahim vendimin e Qeverisë për të riparuar dëmet dhe monumentet historike si



Gani Sadik

dhe shtëpitë e dëmtuara të qytetarëve gjatë ngjarjeve të Marsit.

Është prioritet mbi prioritetet për Kosovën dhe institucionet e saj që të rikthejnë besimin e humbur nga bashkësia ndërkombëtare. Institucionet e Kosovës kanë nevojë që të bashkëpunojnë me UNMIK-un dhe KFOR-in dhe të ndërtojnë partneritet me ta. Si partnerë, ata mund të tejkalojnë së bashku gjithë vështërsitë që kanë katandisur Kosovën.

Kosova kanëvojë për UNMIK-un dhe KFOR-in dhe vetëm përmes dialogut dhe partneritetit me ta, mund të shohim një të ardhme për Kosovën.

Si të kenë të tri gjuhët një zë të vetëm legjislativ?

Hubert van Eck Koster

OMIK Advisory Office in the Office of the Prime Minister

Gjatë procesit të hartimit të ligjeve, shfaqen probleme me saktësinë e përkthimeve që rezultojnë në diskrapancë të madhe mes versioneve finale të ligjeve të miratuara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Kështu, këto ligje të miratura janë jokonsistente dhe jokohereente dhe duket se humbin kuptimin e tyre, ngase njerëzit dhe organet të cilët duhet t'i zbatojnë apo t'u përmbahemi atyre ligjeve nuk arrijnë t'i kuptojnë dot domethënien e tyre. Kjo përkeqësohet akoma më tepër, ngase me t'u bërë një ligj i përkthyer do-bët bazë e ligjeve pasuese, atëherë ligjet e ardhëshme kanë tendencë të përdorin të njëjtën terminologji të gabuar ose edhe nëse terminologjia korrigjohet, atëherë ato dy ligje mbesin në shpërputhje. Veç kësaj, përgjegjësia e publikimit të ligjeve të miratuara, në mes tjerash edhe për shkak të përkthimit të dobët, ishte temë e debatit midis UNMIK-ut dhe Kuvendit. Në ndërkohë, ligjet e miratuara gjendeshin në faqen elektronike në internet sipas versionit të Gazetës së UNMIK-ut, ndër-sa UNMIK-u nuk pranon përgjegjësinë e saktësisë së teksteve, respektivisht të përkthimeve të ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Së këndejmi, kohë më parë është arritur një ujdj me UNMIK-ut dhe Kuvendit, sipas së cilës Kuvendi merr përsipër përgjegjësinë e saktësisë së përkthimeve të ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Pos kësaj, Qeveria ka ndërmarrë një iniciativë ligjore që përmes një Gazete Zyrtare të sigurojë shpërndarjen e duhur të ligjeve

të miratuara nga Kuvendi. Ndonëse, mospajtimi mes UNMIK-ut dhe Kuvendit lidhur me përgjegjësinë e publikimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi duket se është zgjidhur, për fat të keq kjo nuk i ka kontribuar zgjidhjes së problemit kyq. Prandaj, ligjet e miratuara në Kuvend në të tri gjuhët mbesin ende të papërrputhshme dhe jokohereente, ndaj dhe ka të ngjarë që madje edhe të cënohet sundimi i ligjit në Kosovë. Në dritën e ngjarjeve të fundit të dhunshme të motivuara etnikisht, është e qartë se ekziston një nevojë imediate për t'i adresuar këto probleme gjuhësore, si një nga problemet kryesore në kuadrin e përpjekjeve për integrimin e shoqërisë kosovare.

Shumë probleme të përkthimit dalin në shesh në fazat e hershme kur draft-ligjet përgatiten apo diskutohen nga grupet punuese në Qeveri. Fjala vjen, nuk ekziston ndonjë procedurë për grupet punuese që të sigurohen që ndryshimet e bëra dhe përmbajtja është e njëjtë në të tri gjuhët, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Madje, nuk ka as përkthim profesional për vërejtjet me shkrim të ekspertëve të jashtëm në të tri gjuhët për draft ligjet që shqyrtohen nga anëtarët e grupeve punuese. Po kështu, probleme me përkthim ka edhe gjatë takimeve të grupeve punuese. Kjo është si pasojë e mosekzistimit të një rregulle efektive të punës për t'i udhëzuar grupet punuese rreth çështjeve të përkthimit me shkrim dhe me gojë, dhe çfarë është më me rëndësi, mungon një kapacitet i mirëfilltë i përkthimeve në Qeveri. Kështu, problemet që



shfaqen në grupet punuese është vështirë të zgjidhen, prandaj ato ngelin edhe pas miratimit të draft ligjeve nga Kuvendi, rishqyrtimit nga Zyra e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut dhe aprovimit nga PSSP-ja.

Ligji për Antidiskriminim është një shembull tipik i implikimeve politike që mund të shkaktojnë pasaktësitë e përkthimeve. Gjatë leximit të parë të Ligjit të Antidiskriminimit, Koalicioni Kthimi papritur votoi kundër kërtyj projekt-ligji. Ndërkohë, që Bashkësia Ndërkombëtare u mundua me lloj lloj teorish politike të shpjegojë pse ndodhi kështu, doli në pah se në fakt arsyeja ishte përkthimi i dobët në gjuhën serbe. Me miratimin e Ligjit pas shqyrtimit të dytë Koalicioni i Kthimit madje sfidoi Ligjin e bazuar në Nenin 9.1.39 të kornizës Kushtetuese. Në përgjithësi, Kuvendi shpeshherë ka shfaqur pakënaqësinë e tij për cilësinë e teksteve të projekt-ligjeve që dërgohen nga Qeveria.

Një pjesë e problemit është zgjidhur nga ana e GTZ-së, një pro-

jekt i BE-së i udhëhequr nga AER, në Zyrën e Kryeministrit. GTZ ka formuar Njësinë për standardizim/verifikim në Zyrën e Kryeministrit, e cila po bën jo vetëm verifikimin e përputhshmërisë së projekt ligjeve me ligjet e BE-së dhe Kornizën Kushtetuese, por edhe të çështjeve gjuhësore/ të përkthimit për të gjitha draft-ligjet. Përveç kësaj, GTZ është duke punuar në përmirësimin e udhëzimit administrativ 1/2002 të procedurës së përpilimit dhe dorëzimit të ligjeve Qeverisë dhe Kuvendit. Me anë të këtij udhëzimi do të bëhet e mundur që grupet punuese të kenë udhëzime më të qarta mbi çështjet administrative dhe të përkthimit dhe njëherësh do të kërkohet nga Qeveria që të formohen Njësi të standardizimit/verifikimit në të gjitha ministratitë.

Kësisoj, ngel një zbrastërë e kapacitetit të përkthimit gjatë tërë procesit të hartimit të ligjeve nëpër grupe punuese. Në veçanti, ka nevojë për ndihmë gjatë përkthimit në gjuhën angleze, meqë Qeveria nuk mund të bëjë një punë të tillë.

Korniza Kushtetuese kërkon nga Kuvendi dhe Qeveria që vetëm të mbajnë takimet dhe përkthimet vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe. Edhe sikur IPVQ-të të kenë vullnetin e mirë të punësojnë përkthyesë profesionistë gjyqësorë, kjo vërshtirë se do të mund të arrihej, ngase pagat e UNMIK-ut janë shumëfish më të mëdha krahasuar me ato të shërbyesve civilë që paguhen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për atë njëjtin vend pune si përkthyes për gjuhën angleze. Sidoqë të jetë, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare shpesh janë anëtarë të grupeve punuese dhe prandaj kërkojnë komente për projekt ligje në gjuhën angleze, gjë që është mjaft e vështirë të sigurohen. Sigurimi i versioneve të përkthyer në mënyrë profesionale në gjuhën angleze, do t'ia bënte të mundur bashkësisë ndërkombëtare që t'i japë vërejtjet për ato pjesë të projekt ligjeve që do të mund të shkaktonin gabime të papërmirësueshme në fazat e mëtejshme të hartimit të tyre. Ndaj dhe përkrahja e IPVQ-ve për të siguruar shërbime profesionale të përkthimit në gjuhën angleze, do të ishte me interes si të IPVQ-ve ashtu edhe të bashkësisë ndërkombëtare.

Përkundër faktit që Qeveria dhe Kuvendi janë të obliguar që të ofrojnë versione në gjuhën serbe dhe shqipe të projekt ligjeve, versionet serbe shpesh janë të një cilësie të dobët. Kohë më parë, Shtylla e II-të ka formuar një grup pune për të shqyrtuar vështirësitë e vazhdueshme të autoriteteve administrative të Kosovës lidhur me shërbimet e përkthimit dhe ka dhënë disa rekomandime për t'i adresuar këto problemeve. Konkluzioni kryesor ishte se mungojnë kapacitetet e përkthimit nëpër ministri (dhe komuna), ndaj dhe ky grup punues ka sugjeruar,

mes tjerash, edhe krijimin e njësie të përkthimit nëpër të gjitha ministrinë.

Sakohë që të nevojiten përkthyesë të gjuhës angleze dhe përderisa Qeveria të mos themelojë njësi profesioniste të përkthimit në të gjitha ministrinë, do të ekzistojë një nevojë reale për përkrahje në përkthime, duke pasur parasysh implikimet e mundshme të lartpërmendura. Për fat të keq, nuk mund të pritët nga IPVQ-të që t'i formojnë njësitë e nevojshme për të ofruar shërbime profesionale të përkthimit në gjuhën shqipe dhe serbe brenda një kohë të shkurtër. Nevojiten ekspertë juridikë që do të jenë në gjendje t'i përkthejnë ligjet në mënyrë profesionale, ndonëse do të jetë tejet e vështirë për IPVQ-të që t'i punësojnë ata duke patur parasysh pagat e ulta të buxhetit të Kosovës, mungesën e përkthyesve të profilizuar dhe nivelin e pagave të shërbimit civil. Meqë përkrahja IPVQ-ve për të ofruar shërbime profesionale të përkthimit do të ishte si në interesin e IPVQ-ve ashtu edhe të bashkësisë ndërkombëtare, dhe meqë IPVQ-të nuk mund ta bëjnë këtë punë, atëherë bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të hezitojë që të ndihmojë në këtë drejtim sa më parë që të jetë e mundur. Përfaqësuesit nga bashkësia ndërkombëtare duhet të marrin pjesë dhe të konsultohen gjatë gjithë procesit ligjor dhe të marrin përsipër përgjegjësinë e përkthimeve në gjuhën angleze. Derisa, Qeveria duhet fuqimisht të inkurajohet që të themelojë njësitë e përkthimit, bashkësia ndërkombëtare duhet të ndihmojë në procesin e përkthimit, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte, fjala vjen edhe përmes fuqizimit të institucioneve vendore me ekspertizë ligjore, që do të angazhoheshin përkohësisht për të ndihmuar Qeverinë, duke kryer detyrat e përkthimit

profesional. Posa të jenë formuar njësitë për shërbime gjuhësore, bashkësia ndërkombëtare duhet të përqëndrohet në përforcimin e kapaciteteve të njësie gjuhësore, p.sh duke aktivizuar kapacitetet vendore për të siguruar që shërbimet e përkthimeve juridike të jenë të integruara në mënyrë të qëndrueshme dhe politikisht neutrale në të gjitha procedurat ligjvënëse. Megjithatë, bashkësia ndërkombëtare duhet të vazhdojë me ndihmën e saj për sa

kohë që të jetë e nevojshme, ngase ka të ngjarë që shërbimet e përkthimit të mos jenë në gjendje të ofrojnë shërbime të duhura të përkthimit në gjuhën angleze.

Këto masa do të kontribuojnë dukshëm në procesin ligjvënës sa i takon përkthimit të draft-ligjeve, të cilat shpresojmë se do të rezultojnë në përmirësimin e sundimit të ligjit, dhe të lëvizjes një hap para në drejtim të integritetit të shoqërisë kosovare.

Fjalori në tri gjuhë i terminologjisë parlamentare dhe juridike

Për të zgjidhur një problem kyç me të cilin përballen IPVQ-të, misioni i OSBE-së në Kosovë ka inicuar një projekt për të mbështetur Kuvendin dhe Qeverinë rreth hartimit të Fjalorit në tri gjuhë të termeve parlamentare dhe juridike. Dhe kjo në rradhë të parë po bëhet për të lehtësuar punën e përpilimit të ligjeve dhe procesit të përkthimit të dokumenteve, pastaj për të ndihmuar debatin parlamentar gjatë përgatitjes së legjislationit si në mbledhjet e komisioneve ashtu edhe në sesionet plenare. Në bashkëpunim me Departamentin Juridik të Sekretariatit të Kuvendit, Zyrën e Kryeministrit dhe Programin Gjuhësorë Parlamentar të NDI në Shkup (i cili ishte i angazhuar më parë në një projekt të ngjashëm), projekti në fjalë ka për synim përpilimin e termave juridike dhe parlamentare që po përdoren nga subjektet ligjvënëse dhe ato qeveritare, por edhe nga institucionet e BE-së. Fjalori më parë do të përpilohet në gjuhën angleze për të vazhduar më pas me gjetjen e barasvlerave ose ekuivalencave të tyre në gjuhën shqipe dhe serbe, duke siguruar me atë rast definicionin, sinonimet dhe shembujt e saktë të përdorimit të terminologjisë.

Për të zbatuar projektin më parë u emërua një kordinator, pastaj u formua Bordi i Projektit tok me Këshillin Redaktues. Njëherazi, janë vënë marrëdhënie zyrtare mes partnerëve të ndryshëm të involvuar në projekt. Zbatimi i projektit që ka filluar me 1 tetor 2003, është planifikuar të kryhet në pesë faza: [1] identifikimi dhe përzgjedhja e termave; [2] përkthimi; [3] verifikimi i materialit të përpunuar gjatë seminareve; [4] lektorimi dhe rishqyrtimi gjuhësorë; [5] faqosja dhe botimi në versionin e shtypur dhe atë elektronik. Versioni final është parashikuar të jetë gati në fund të gushtit 2004.

Doina Ghimici, OSBE

Përvoja e tre parlamenteve në përkrahje të Kuvendit

Pas periudhës tremujore të fillimit dhe vlerësimit, projekti i Agjencionit Evropian i Rindërtimit (AER) "Përkrahja për Kuvendin e Kosovës", tanimë ka hyrë në një fazë më aktive të realizimit. Veprimtaria kryesore e tre ekspertëve kryesorë – z. Heinrich Grose-Sender, ekspert i lartë për reformë ligjore/hartime parlamentare, Z. Alfred Drescher, ekspert i lartë për burime njerëzore dhe menaxhim të personelit dhe z. Peter Vanhojite, ekspert i lartë i logjistikës së bashku me udhëheqësin e ekipit – mbuluan fushat më të rëndësishme që kanë të bëjnë me funksionimin e Kuvendit të Kosovës në të ardhmen.

Prof. Dr. Nicolas Maziau, Udhëheqës i Ekipit AER-Konzorciumi i tri parlamenteve Këshilltar i Sekretariatit dhe Kryesisë

Në sferën e ndërtimit të institucioneve, ekipi i projektit ka ndërmarrë tri aktivitete kryesore me ambicie për të bërë ca ndryshime në mënyrën e funksionimit të Kuvendit, para zgjedhjeve të ardhshme.

[1] Zhvillimi i strategjisë për riorganizimin e Kryesisë dhe Sekretariatit. Me këtë çështje është marrë Z. Korini Ljukiens, ekspert me kontratë afat-shkurte për projektin dhe Drejtoreshë për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Kuvendin Kombëtar të Francës. Sipas propozimeve të saj, ekipi i projektit do ta hartojë një plan të përgjithshëm për ta përmirësuar organizimin e Sekretariatit, për ta bërë atë sa më të efektshëm dhe sa më të përshtatshëm për nevojat e një Kuvendi, i cili ballafaqohet me detyrat që dalin gjatë zhvillimit të tij. Njëherësh, edhe propozimet që kanë të bëjnë me Kryesinë do të shqyrtohen për ta bërë atë sa më të efektshme dhe transparente.

[2] Redukimi i numrit të komisioneve në Kuvend është një çështje me rëndësi të veçantë. Kuvendi, siç është i organizuar tani, i ka 19 komisione, 2 komisione kryesore dhe 17 komisione funksionale. Kur kemi parasysh numrin e anëtarëve të Kuvendit (120), një numër kaq i madh i komisioneve parlamentare është burim i joefikasitetit. Sipas propozimit të projektit parashikohet që ky numër të reduktohet, mundësisht deri në 10, përmes bashkimit. Pozitat e reja, si ajo e nënkryetarit dhe raportuesit do

të ndikojnë në përmirësimin e kapacitetit legjislativ të komisioneve, në cilësinë e legjislacionit dhe në aftësinë e tyre për të siguruar informata në mënyrë adekuate për seancat plenare. Njëherazi, një kusht me rëndësi për suksesin e kësaj reforme do të ishte që kjo të bëhet financiarisht neutrale për anëtarët e Kuvendit. Diskutimet janë ende duke u zhvilluar dhe janë mirëpritur nga kryesuesit e komisioneve. Së këndejmi, shpresohet se për këto çështje do të merret një vendim para verës që do të hynte në fuqi pas zgjedhjeve të ardhshme.

[3] Përmirësimi i procesit legjislativ në mes të Qeverisë dhe Kuvendit është njëra nga çështjet më kyçe, që nevojitet të shkoqitet urgjentisht. Prandaj, ekipi i projektit është duke punuar rreth kësaj çështje tok me përfaqësuesit e Qeverisë për të gjetur një zgjidhje lidhur me krijimin e marrëdhënieve korrekte dhe të përhershme ndërmjet Zyrës së Kryeministrit, ministrive dhe Kuvendit. Një vlerësim i situatës është bërë nga dy ekspertët me kontratë afat-shkurte, z. Alberik Goris, zëvendës-kryesues i Departamentit Ligjor të Dhomës së Përfaqësuesëve të Belgjikës dhe z. Joakim Kehrhahn, Sekretar i Komisionit për ushqim dhe bujqësi në Bundestagun gjerman. Qëllimi është që t'i propozohet Zyrës së Kryeministrit dhe Kuvendit një memorandum i mirëkuptimit ku do të përfshiheshin çështje të ndryshme për të cilat të dy institucionet kanë rënë dakord që të punojnë së bashku



Nikollas Maziau

me qëllim të përmirësimit të kontakteve të përditshme ndërmjet ekzekutivit dhe legjislativit. Është kërkesë themelore e demokracisë parlamentare që të autorizohen përfaqësuesit e Qeverisë për pjesëmarrje në çdo kohë në punën e komisioneve kur diskutohet një propozim-ligj. Pokështu, është e domosdoshme që ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit të sigurojnë qasje më të mirë në informata për anëtarët e komisioneve. Së këndejmi, si Rregullorja e Punës së Kuvendit ashtu edhe Rregullorja e Punës së Qeverisë do të duhej të amandamentoheshin.

Prandaj ky është edhe misioni i z. Mishel Leroy, Kryetar i dhomës në Këshillin Shtetëror

të Belgjikës, dhe z. Ronald Mes, Drejtor në Dhomën e Përfaqësuesëve të Belgjikës, të cilët erdhën në muajin shkurt për ta vlerësuar mundësinë e krijimit të Këshillit Legjislativ në Kosovë. Nëse formohet ky institucion i ri do të ishte i pavarur nga Qeveria dhe Kuvendi dhe do të ishte i përbërë prej juristëve me kualifikime të larta. Funksioni i tij do të ishte ekskluzivisht këshillëdhënës, ndaj dhe Këshilli do të merrej me

shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislativitetit dhe pajtueshmërinë e tij me Kornizën Kushtetuese dhe standardet evropiane. Në kuadër të këtij misioni të këtyre dy ekspertëve, ekipi i projektit synon ta propozojë një propozim-ligj, i cili do të shqyrtohej në një fazë të mëvonshme.

Në sferën ligjore, Projekti po përqëndrohet në dy çështje:

[1] Ndhimën teknike për punën e komisioneve, në veçanti për gjashtë komisionet që konsiderohen si të rëndësishme për projektin; dy komisionet kryesore, komisioni për Çështje Ligjore, Legjislativ dhe të Kornizës Kushtetuese, komisioni për Tregëti dhe Industri, Komisioni



Angazhimi politik i rinisë dhe kredibiliteti i institucioneve

Nga Lulzim Zeneli,
deputet i LDK-së në Kuvendin e Kosovës

Angazhimi i të rinjve në politikë nuk duhet të merret assesi si një temë tabu. Kështu, ekziston një gjeneratë e tërë e lidërshipt kosovar që me gjasë i ka keqkuptuar qëllimet dhe pretendimet e brezit të ri për t'u futur në politikë dhe për të krijuar karrierë politike.

Njëkohësisht, angazhimi i të rinjve kurrsesi nuk guxon të mbesë në nivel të angazhimit formal në rrjedhat politike e shoqërore në vend.

Angazhimi i rinisë, brenda dhe jashtë Kosovës, si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë institucional, tani është më i rëndësishëm se kurrë më parë. Së këndejmi, kosovarët e rinj me energjinë, vullnetin dhe guximin e tyre, duhet të japin kontributin e tyre për t'u përballur me problemet praktike në teren, për fushat që ata i zgjedhin.

Angazhimi politik i një brezi të ri me ide dhe vizione përparimtare e properendimore, në

asnjë formë nuk do të duhej të keqinterpretohet, përkundrazi kjo nënkupton një ambicie shumë të shendoshë për t'u integruar në proces, e për të mos mbetur anash, si vrojtues pasiv, siç po ndodh tani.

Tek e fundit, në cilin do plan vetëm pjesëmarrja në procese ka kuptim, në të kundërtën, shoqëria jonë rrezikon të shndërrohet në një shoqëri jo aktive dhe të marrë një dimension tjetër, afër mendsh të padëshirueshëm që do të reflektohej tejet negativisht në proces.

Angazhimi i një të riu kosovar sot në politikë, ka kuptim edhe më të gjërë sesa vetëm formal. I riu kosovar në politikë është dëshmi e kreativitetit dhe ener-



Lulzim Zeneli

gjisë rinore të shoqërisë sonë.

Tash shtrohet pyetja se në ç'nivel është ky angazhim i të rinjve në politikë? Unë them, se rinia jonë duhet të jetë edhe më e përfaqësuar në të gjitha nivelet

e shoqërisë dhe të udhëheqjes së vendit. Ngase vetëm një përfaqësim meritor i brezit të ri në nivele të vendimmarrjes, do të reflektonte edhe kredibilitet më të madh të institucioneve tona.

Ngjarjet e 17 dhe 18 marsit të këtij viti në vend, dhanë shembullin më të keq të mundshëm. Fatkeqësisht, shumë nga ata që u bënë pjesëtarë të akteve të dhunës ishin të rinj, adoleshentë.

Veprimet e tilla, dëmtuan imazhin jo vetëm të Kosovës, por edhe të shoqërisë sonë në përgjithësi. Për këtë arsye, institucionet tona janë vënë në një pozitë shumë të vështirë, ngase lipset shumë punë për t'u bërë me ç'rast si institucionet vendore ashtu edhe ndërkombëtare duhet t'i dyfishojnë përpjekjet dhe angazhimet e tyre në të gjitha segmentet e jetës dhe zhvillimit të saj dhe çka është më rëndësi duhet të bëjnë fuqizimin e kredibilitetit institucional, ku edhe duhet të jemi optimist!

për Shëndetësi dhe komisioni për Transport dhe Komunikime. Të dhënat e projektit po gjejnë vend përmes njësisë së standardizimit, e cila do të zhvillohet nga Eksperti i lartë ligjor vendor i projektit, z. Virtyt Ibrahimaga së bashku me ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë me kontrata afat-shkurta dhe Sekretariatit e Kuvendit. Z. Frederik Bredilol, administrator në Komisionin për Çështje Ekonomike në Kuvendin Kombëtar të Francës ishte eksperti i parë që arriti në muajin shkurt dhe e dha kontributin dhe ndihesën e tij. Nga ai u kërkuar që ta rishikojë përpunshëm rësinë me standardet evropiane të propozim-ligjeve për energji

të përgatitura nga Komisioni për Tregëti dhe Industri me ndihmën e USAID-Baring point.

[2] Komentet kritike për Rregulloren e Punës janë në përgatitje e sipër. Eksperti me kontratë afatshkurtër i projektit, z. Mark van der Hulst, Drejtor i Departamentit Ligjor të Dhomës së Përfaqësuesëve të Belgjikës erdhi për të dhënë një vlerësim. Raporti i tij propozon disa amandamente teknike për ta bërë procesin legjislativ më të përshtatshëm dhe më të zbatueshëm. Në të vërtetë, Rregulloret e Punës si duket janë mjaft të ndërlikuara, madje edhe kontradiktore, gjë që ndikon në zvogëlimin e kapacitetit të Kuvendit për

miratimin e ligjeve. S'do mend se këto komente do t'i dorëzohen Kuvendit dhe do të diskutohen përsëri me të gjitha palët relevante, përfshirë këtu edhe partnerët e ASI-it.

Në sferën e administrimit, ekipi i projektit është duke i përgatitur statusin për personelin që do t'i propozohen Kuvendit deri në qershor të vitit 2004. Eksperti me kontratë afat-shkurte, z. Lorent Kllajn, drejtor i arkivave dhe ish udhëheqës i personelit në Kuvendin Kombëtar të Francës erdhi për të bërë një vlerësim dhe njëherësh tok me ekspertët kryesorë të projektit do të propozojë rregulloret e reja, të cilat, bashkë me sistemin e karrierës, do të

duhej të ndihmonin në zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit civil profesional të Kuvendit.

Fare në fund, sa i takon përkrahjes logjistike për Kuvendin, ekipi i projektit ka filluar ta përgatisë planin e përtrirjes së teknikës, që do të përfshijë përmirësimin e rrjetit telekomunikues, zhvillimin e një rrjeti informativ, por njëkohësisht do të bëhet edhe renovimi i ndërtesës. Z. Frenk Blum, koordinator i ICT në Bundestagun gjerman ka për detyrë që të bëjë ca propozime. Veç kësaj, eksperti kryesorë i projektit aktualisht është edhe duke i përgatitur rregullat e reja të prokurimit për Kuvendin.

Promovimi i tolerancës

Nga Edita Tahiri, deputete e Kuvendit të Kosovës

Një udhëtim këtë vit për të promovuar tolerancën përmes programit të "Komitetit Hebrejsh Amerikan" dhe "Fondacionit Fridrih Nauman" (FNS) ishte një përvojë e rrallë për mua. Pas debatit të parë frymëzues mbi tolerancën në Shkup/ Maqedoni dhe Sinaia/ Rumuni, pasoi udhëtimi për hir të tolerancës në Shtetet e Bashkuara. Për pjesëmarrësitë jo vetëm nga vendet post-komuniste, por edhe nga vendet "që kanë dalur nga lufta", si në rastin tim, me frymën dhe idetë e çmuara të tij e begatoi si mendjen ashtu edhe shpirtin tonë.

Programi për Promovimin e Tolerancës për vitin 2003 u përqëndrua rreth rolit të historisë në promovimin e tolerancës në Evropën Qendrore, Jugore dhe Lindore. Në këtë ngjarje morën pjesë si përfaqësues nga këto rajone, ashtu edhe nga Shtetet e Pavarura të Komonveltit. Prejardhja jonë nga vende të ndryshme, si udhëheqës të ardhshëm dhe mendimtarë të demokracisë së re, na bëri të mundur që t'i hyjmë një debati krijues për të shqyrtuar dhe hetuar ndikimin e historisë në marrëdhëniet mes shteteve dhe popujve. Në seminarin e mbajtur në Shkup në prill të vitit 2003 dhe në Sinaia në maj të vitit 2003, ne diskutuam mbi historinë e Ballkanit dhe paragjykimet që ka krijuar ajo. Kemi bërë përpjekje që të analizojmë deri në çfarë mase mund të ketë historia ndikim në identitetin e një individi apo kombi. Dhe më pas iu kemi kthyer së ardhmes dhe jemi përpjekur të përgjigemi në pyetjet: se a mund të na mësojë historia të bëhemi tolerant? Apo, a mund të ndërtohet toleranca mbi themelet e padrejtësive historike? Kështu, raportet nga vendet ku pjesëmarrësit pasqyruan vuajtjet dhe padrejtësitë personale dhe kombëtare ishin një kontribut i rëndësishëm në debat. Tejkalimi i "padrejtësive historike", sipas mendimit tim është sfida kryesore në ndërtimin e së ardhmes

Në këtë kontekst, në raportin për vendin tim unë pasqyrova të kaluarën tragjike të popullit tim, duke u përqëndruar veçmazi rreth vuajtjeve të dhjetë viteve të fundit. Fola për perspektivën e ndërtimit të një shoqërie tolerante dhe të drejtë në Kosovë dhe Evropën Juglindore. Njëherësh, vura në dukje se ne mund të ndërtojmë një të ardhme tolerante vetëm duke i korrigjuar padrejtësitë. Për Ballkanin kjo do të thoshte miratimi i kornizave ligjore dhe politike për të zgjidhur çështje të pazgjidhura. Ndërsa, për Kosovën, si një nga çështjet më madhore të pazgjidhura të Ballkanit, kjo do të thotë njohjen e së drejtës për vetëvendosje për popullatën e Kosovës dhe që tu mundësohet një jetesë e sigurtë në një shtet të pavarur. Gjatë shkoqitjeve të mia unë poashtu theksova se zhdukja e frikës së mbjellur, është një parakusht për të ndërtuar tolerancën dhe se kjo mund të arrihet kur shqiptarët ta kenë sigurinë dhe shtetin e tyre të pavarur. Prezantimin e përfundova me konstatimin se: "Ne nuk mund të presim nga një popull që të veprojë drejtë nëse atij populli nuk iu është dhënë drejtësia".

Do thënë se debati mbi rolin e historisë për promovimin e tolerancës bëri të mundur që pjesëmarrësit të paraqiten me qasje mjaft gjithëpërfshirëse. Ky debat qiti në shesh ca mendime mjaft të dobishme. Dukej sikur të gjithë ishim të gatshëm që të impenjohe mi rreth sfidës së madhe për t'i ndihmuar vetvetes dhe Evropës duke tejkaluar të kaluarën. Vërtetë, bëmë një hap përpara drejt dialogut, mirëkuptimit dhe tolerancës. Së këndejmi, kujtoj se tanimë jemi të gatshëm për një udhëtim në SHBA me qëllim që të përfitojmë nga përvoja demokratike e SHBA-ve.

Programi filloi me filmin nga ngjarja e vërtetë për tolerancën "Remember the Titans". Pastaj vajtëm në Shkollën e Lartë "T.C.



Edita Tahiri

Williams" në Feirfaks, Virginia, ku u takuam me "titanët e tolerancës". Ne biseduam me stërgjyshërit e tyre, pamë pasqyrën e vërtetë të një fryme tejet njerëzore – unitetin e studentëve të të gjitha racave. Veç kësaj, gjatë ditëve në vijim ne patëm rastin të takojmë njerëz dhe ekspertë të ndryshëm, të cilët janë në shërbim të tolerancës. Njëherësh, u njohëm edhe me iniciativat amerikane që kanë për qëllim inkurajimin e respektit për diversitetin në shoqërinë e tyre. Aty pamë se ekzistonte një mozaik i tërë i akterëve dhe ideve që vë në lëvizje makinën e demokracisë amerikane. Patëm rastin që të përcjellim dhe të marrim pjesë edhe në debatin mbi avansimin e tolerancës përmes OJQ-ve, i cili u përqëndrua më tepër në çështjet racore, etnike, shoqërore, religjioze, etj. Ne kuptuam se çfarë bën qeveria për të nxitur e përhapur tolerancën; kështu, ne patëm rastin të shohim edhe punën që bën Departamenti i Drejtësisë – Shërbimi për Marrëdhënie të Komunitetit – rreth negociatave për zgjidhjen e konflikteve racore. Sipas mendimit tim, institucionet e Kosovës duhet të përvetësojnë e të vënë në jetë praktika të ngjajshme. Pas Uashington D.C. vizituam qytetin e famshëm të Nju Jorkut dhe selinë e AJC-së. Atje u pritëm nga Kryesuesi i AJC z. David Harris dhe bashkëpunëtorët e tij. Pas fjalimit vizionar të z. Harris, nuk ishte e vështirë për mua që të kem të qartë përse AJC-ja ishte aq e suksesshme. Qëndrimi ynë në

Nju Jork u përbyll me vizitën në "Ground Zero", monumenti i viktimave të tragjedisë së 11 shtatorit.

Pastaj, pjesëmarrësit u shpërndanë në grupe të ndryshme për të vizituar degët e AJC-së nëpër tërë SHBA-të. Unë bëra një vizitë në Degën e Detroitit ku pata rastin të njihem me gamën e gjerë të aktiviteteve që zhvillon kjo degë me komunitetin hebrejsh, si dhe veprimtari të tjera në nivelin komunal me komunitetet tjera. Isha e impresionuar me projektin e tyre vjetor "Mos harroni të huajin", që ka për qëllim mikpritjen e liderëve jo-hebrejsh. Momen ti i paharrueshëm i kësaj vizite ishte edhe pritja e ngrohtë e familjes Traison në drekën e festës së Shabbatit. Njëherësh, unë morra pjesë edhe në ceremoninë e Shabbatit në Sinagogë ku përshtypje të veçantë ka lënë debati intelektual që u zhvillua atje. Kësaj rradhe, më bën një nder të veçant kur më lutën të mbajë një fjalim në Sinagogë.

Pjesa e fundit e programit ishte ritakimi ynë në Çikago. Në drekë ne shkëmbyem mbresat dhe pikëpamjet tona gjatë vizitave nëpër degë. Vizita në Çikago, e organizuar nga Dega e AJC-së në Çikago, u përqëndrua kryesisht në çështjet të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërfaqet. Së fundi, u takuam edhe me përfaqësues të shoqërisë civile, pushtetarët bashkiakë dhe policinë e Çikagos për të mësuar mbi idetë dhe përvojat e tyre. Pika kulmore e kësaj vizite ishte diskutimi i mbrëmjes mbi marrëdhëniet katoliko-hebreje në Bregun Verior të Izraelit.

Nuk mund të përfundojë këtë raport pa përmendur vizitën në "Muzeun e Holokaustit" në Uashington D.C. Kjo ishte vizita ime e dytë (për herë të parë e pata vizituar në vitin 1993, kur sapo ishte hapur), dhe porosia: "Se ne duhet të dëshmojmë si për të ndërjet ashtu edhe për të gjallët" vlen tani më shumë se kurrë. Kjo porosi ma përkujton edhe historinë e popullit tim.

"Ne duhet të investojmë në stafin e ri të Kuvendit"

Intervistë me Sali Rexhepi, kryesues i Sektorit për Çështje Plenare dhe Procedurale në Kuvend

By Ali Caka, UNDP

Z. Sali Rexhepi, a mund të shpjegoni ju si kryesues i Sektorit për Çështje Plenare dhe Procedurale çfarë është roli dhe funksioni i Zyrës suaj?

Roli dhe rëndësia e këtij sektori është me sa vijon: bën pranimin e të gjitha dokumenteve të natyrës legislative, projektligjeve, amandamenteve, pyetjeve të deputetëve, mocioneve, kërkesave, i sistematizon dhe ua shpërndan deputetëve, përkatësisht ministrave pyetjet e deputetëve dhe kujdeset për qarkullimin e të gjitha dokumenteve sipas procedurës legislative.

Në të njëjtën mënyrë është përgjegjëse për seanca plenare të Kuvendit, duke filluar që nga përgatitja e rendit të ditës, deri te shpërndarja e projektligjeve, amandamenteve, projektrezolutave, projektdeklaratave, përkujdesja për çështje të procedurës, hartimi i procesverbaleve, si dhe bën zbatimin e të gjitha vendimeve, përfundimeve dhe rekomandimeve që i miraton Kuvendi.

Kujdeset për komunikimin e brendshëm ndërmjet komisioneve parlamentare me rastin e shqyrtimit të projektligjeve etj.

Çfarë është procedura e dorëzimit të amendamenteve për projektligjet?

Procedura për paraqitjen e ndonjë mocioni apo amendamenti është rregulluar me rregullën e 29 të Rregullores së Punës të Kuvendit. Çdo grup parlamentar apo deputet mund të paraqes ndonjë mocion, rezolutë apo amendament në Sektorin për Çështje Plenare dhe Procedurale, më së voni 5 ditë pune para se të debatohet për atë mocion, rezolute apo projektligj.



Sali Rexhepi

A ka pasur trajnime përkatëse në Sektorin tuaj?

Kuadri i këtij Sektori është i kualifikuar, ka bërë vizita studimore Kuvendit francez dhe Parlamentit belg. Por ka nevojë për trajnime të mëtejme në përvetësimin e përvojave edhe të parlamentave të tjera, si të atij gjerman, anglez, zviceran apo të ndonjë parlamenti tjetër me traditë parlamentare.

Por ajo që do të ishte e dëshirueshme për punën tonë të ardhshme është: përzgjedhja e duhur e stafit dhe investimi në aftësimin e tyre, por jo në gjeneratat e vjetra. Të mos shpenzohet kohë në trajnimin e stafit të moshuar pasi që përvoja jonë ka dëshmuar se kanë njohuri të mangët për t'i kryer detyrat dhe përgjegjësitë edhe pas trajnimeve. T'i jepet përparësi punës praktike, përmes mjeteve praktike të punës në lëmitë përkatëse ku është i involvuar edhe stafi i Sekretariatit. Do të ishte më mirë që ndonjeri nga stafi të dërgohet në vizitë pune një muajshe në ndonjërin nga parlamentet që përkrahin punën e Kuvendit

të Kosovës. Shërbyesve civilë duhet vazhduar kontratat e punës së paku tri vite dhe t'u mundësohet sigurimi social dhe shëndetsor.

Cilat janë sfidat kryesore me të cilat ballafaqoheni në punën tuaj si kryesues i Sektorit për Çështje Plenare dhe Procedurale?

Puna e shumtë dhe mungesa e stafit për të kryer punët e nevojshme.

Çfarë është sipas jush arritja më e madhe Kuvendit gjatë këtyre dy viteve të fundit?

Arritja më e madhe e Kuvendit në këto dy vite është vendosja e administratës moderne. Dhe kjo përfshin: Sekretariatine Kuvendit me stafin (e pamjaftueshëm) civil për të ndihmuar veprimtarinë e Kuvendit; miratimin e disa ligjeve, ndërsa ca të tjera janë në procesim e sipër, në përputhje me standardet ligjore të BE-së; përfitimi i një përvoje solide, e cila do të ndihmojnë për punën e legjislacionit.

Sa e çmoni ndihmën e ndërkombëtarëve Kuvendit të Kosovës gjatë mandatit të parë legjislativ?

Përkrahja e stafit ndërkombtar ka qenë e madhe. Në fillim kanë ekzistuar vetëm seksione të vogla për zhvillim, ndërsa në ndërkohë Sekretariati i Kuvendit u zgjerua me staf vendorë. Mbasandej, stafi ndërkombëtarë përmes mënyrave të ndryshme të konsultimeve, udhëzimeve dhe trajnimeve ka luajtur rol aktiv, duke ndihmuar punën e Kuvendit, gjë që ne e çmojmë lartë. Ato çfarë më së shumti kemi nevojë janë trajnimet dhe investimet. Investimet në stafin e ri.

Partnerët e ASI-it kanë filluar me përgatitjet e programit të asistimit për Kuvendin e ardh-

shëm. Cilat sipas mendimit tuaj, do të duhej të ishin prioritet kryesore?

ASI duhet të përqëndrojë aktivitetet e veta në lëmitë përkatëse si: trajnimin e stafit për të përpiluar dokumente, bashkëpunimin mes grupeve parlamentare, deputetëve dhe shërbyesve civil që i ndihmojnë ata, organizimin e kurseve intensive të gjuhës angleze, aftësimin e stafit të Kuvendit për të përdorur dhe aplikuar teknologjinë informative në aktivitetet parlamentare, si dhe pajisjen me përvojën e parlamenteve me traditë parlamentare.

Çfarë mendoni se do të duhej përmirësuar në punën e Sekretariatit të Kuvendit në përgjithësi, dhe në punën e Sektorit për Çështje Plenare dhe Procedurale, në veçanti?

Mendojqënë pozitativisht duhet të vijin vetëm ata njerëz që kanë njohuri menaxheriale, integritet personal, njerëz profesionist dhe me moral të lartë, të cilët nuk janë të korruptuar dhe që kanë marrëdhënie të mira ndërmjetore. Kjo do të siguronte funksionimin e një administrate moderne, profesioniste dhe politikisht të paanshme. Me këtë rast, duhet luftuar dukuritë e privilegjimit në saje të përkatësisë partiake dhe nepotizmit.

Informatat për të kontaktuar Sektorin për Çështje Plenare dhe Procedurale:

Sali REXHEPI
Kuvendi i Kosovës
email: s_rexhepi@hotmail.com
Tel. +381/38 211 598

Raportimet në fund të mandatit: Një hap përpara drejt krijimit të memories institucionale

Doina Ghimici, OSBE



Kuvendit të Kosovës po i afrohet përfundimi i mandatit të tij të parë. Ishin këto tri vite mjaft sfiduese si për deputetët ashtu edhe për stafin e Kuvendit, të cilëve iu desh që të krijojnë një bazë të mirë dhe të përballen me të gjitha problemet gjatë fazës fillestare të ndërtimit të institucioneve. Ndonëse, Kuvendi i Kosovës, si nga aspekti politik ashtu edhe procedural, ende nuk ia ka dalur mbanë që të bëhet një organ ligjvënës stabil, funksional dhe produktiv, përvoja që është fituar gjatë mandatit të parë megjithatë duhet patjetër të shënohet, analizohet dhe përcillet tek përbërja e re e Kuvendit, i cili do ta merr parasysh atë. POKËSHTU, kjo shënon edhe fillimin e përpjekjeve për krijimin e memories institucionale që do të bëjë të mundur prezantimin e ndihmës ndërkombëtare në mënyrë të vazhdueshme. Komisionet e Kuvendit të Kosovës u përballën me shumë

sfida, shumica e të cilave kanë të bëjnë me fazën fillestare. Me kalimin e kohës, funksionimi i tyre ka avansuar dhe së këndejmi komisionet e Kuvendit tani janë në gjendje që të shqyrtojnë propozimligje pa ndonjë vonesë të paarsyeshme, ndërsa kanë filluar të merren me sukses edhe me iniciimin e akteve legislative. Mbjajta e dëgjimeve publike në shkallë të gjerë, që tanimë është bërë praktikë, përkundrazi rezervave të shprehura në fillim, është një nga shembujt ku përpjekjet e donatorëve ndërkombëtarë kanë qenë të suksesshme. Një aspekt tjetër pozitiv që vlen të përmendet me këtë rast lidhur me funksionimin e komisioneve, është edhe krijimi i marrëdhënieve të rregullta të punës- të spektrit politik dhe komunitar- ndërmjet deputetëve të Kosovës në nivelin e Komisionit. Megjithatë, funksioni i mbikëqyrjes së ekzekutivit nuk është ushtruar si

cesin ligjvënës në Kuvend. Veç kësaj, ka pasur edhe luhajtje në punën e komisioneve të Kuvendit. Kohëve të fundit, për shembull, komisionet shpeshherë nuk arritën të sigurojnë kourum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjeve. Si pasojë, në mbledhjen plenare të mbajtur me 28 prill Kuvendi e shtyri për më vonë miratimin e tri draftligjeve, ngase komisionet përkatëse nuk i kishin marrë në shqyrtim këto draftligje. Së këndejmi, Kryetari i Kuvendit kishte vendosur që ta thërriste një mbledhje me kryesuesit e komisioneve për të adresuar problemet.

Efikasiteti dhe kualiteti i punës, dallojnë nga komisioni në komision. Afër mendsh, që efikasiteti i komisioneve të caktuara, varet drejtëpësdrejt nga profesionalizmi dhe përkushtimi i kryesuesve të tyre. Disa kryesues kanë bërë çmos që t'i kryejnë obligimet legislative me kohë dhe njëherësh

duhet as nga deputetët e Kuvendit në përgjithësi, por as nga anëtarët e komisioneve, në veçanti. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm i disa komisioneve me ministrinë përkatëse dhe niveli i ulët i përgjegjësisë së disa ministrive kanë shkakuar vonesa në procesin ligjvënës në Kuvend. Veç kësaj, ka pasur edhe luhajtje në punën e komisioneve të Kuvendit. Kohëve të fundit, për shembull, komisionet shpeshherë nuk arritën të sigurojnë kourum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjeve. Si pasojë, në mbledhjen plenare të mbajtur me 28 prill Kuvendi e shtyri për më vonë miratimin e tri draftligjeve, ngase komisionet përkatëse nuk i kishin marrë në shqyrtim këto draftligje. Së këndejmi, Kryetari i Kuvendit kishte vendosur që ta thërriste një mbledhje me kryesuesit e komisioneve për të adresuar problemet.

janë impenjuar jo vetëm rreth kontrollimit të aktiviteteve të Qeverisë, por edhe të vlerësimit të situatës në terren. Pos kësaj, disa kryesues të komisioneve kanë marrë iniciativa për të hartuar raporte vjetore mbi punën e komisioneve të tyre.

Ne mendojmë se është me rëndësi që t'i nxisim të gjithë kryetarët e komisioneve që të hartojnë- raportin në fund të mandatit- në të cilin do të pasqyroheshin si përvoja positive dhe negative e komisioneve, ashtu edhe planet dhe idetë, të cilat për arsye të ndryshme, nuk janë vënë në jetë gjatë mandatit të këtij organi ligjvënës. Kryesuesit mund ta shkruajnë raportin ose vet në konsultim me anëtarët e komisionit, ose edhe t'ia ngarkojnë këtë detyrë ndonjë anëtar tjetër, i cili është i gatshëm për të raportuar në emër të komisionit. Është me rëndësi që informatat që përfshihen në- raportin në fund të mandatit- të jenë sa më të sakta dhe sa më relevante që është e mundur dhe që të ketë vlerësime si kualitative ashtu edhe kuantitative. Për këtë arsye, partneret e ASI-it janë të gatshëm që të ndihmojnë dizajnimin e formatit për këto raporte dhe të propozojnë një model dhe udhëzime të caktuara përfshirë këtu shembuj të pyetjeve që lipset përgjigjur në raport. Web-faqja e Kuvendit që u sponsorizua nga OSBE-ja, do të ishte vendi më i përshtatshëm për t-a bërë publike punën e komisioneve. Për më tepër, OSBE-ja ka shprehur gatishmërinë që të ndihmojë në hartimin e raportit për fund të mandatit.

Recent Support Activities

EWPPP-ja konsulton lidhur me zgjedhjet e ardhshme

Në suazën e kornizës së programeve të Programit të Praktikës Parlamentare Lindje Perëndim (East West Parliamentary Practice Program - EWPPP) z. Valk dhe unë, që të dytë politikanë nga Holanda, vizituam Prishtinën nga data 12 deri më 15 shkurt. Gjatë vizitës mbajtëm takime me udhëheqës dhe politikanë të shumë partive politike. Temat kryesore në këto biseda ishin zgjedhjet qendrore që po afrohen dhe veprimtaria e komisioneve në Kuvend.

Gjatë diskutimeve ishte gjithashtu i qartë koncenzi i përgjithshëm se përbërja e Kuvendit do të ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme pas zgjedhjeve. Përfitim që do të vinte nga seminari për adresimin e punës së komisioneve do të ishte më i efektshëm nëse do të mund të merrnin pjesë edhe anëtarët e rinj.

Takimi me Kryeministrin Bajram Rexhepi ishte shumë i dobishëm. Ai na informoi për nivelin e legjislacionit dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet gjatë hartimit të ligjeve dhe aprovimit të tyre me kohë nga Kuvendi. U vlerësua edhe roli i organizatave ndërkombëtare, duke e përfshirë OSBE-në dhe UNMIK-un.

Në vizitën e fundit na priti z. Ismet Beqiri, Kryetari i Kuvendit Komunal të Prishtinës, me disa nga këshilltarët e tij. Me këtë rast, e patëm të qartë se Prishtina po ballafaqohet me probleme të ngjashme si edhe të gjitha qytetet e tjera, bile më të rënda. Nevojiten më shumë mjete financiare për t'i plotësuar të gjitha detyrat relevante komunale, por gjithashtu edhe banorët e Prishtinës duhet të jenë më të edukuar sa i përket detyrave private që duhet t'i kryejnë qytetarët e një qyteti.

Jan Dirk Blau

Këshilltar për çështje politike dhe ekonomike EWPPP Holandë

Trajnim mbi Lirinë e Informimit

Trajnimi mbi Lirinë e Informimit (TLI), që poashtu njihet edhe si Ligji mbi qasjen në dokumentet publike, u mbajt ashtu si ishte parashikuar nga mesi i muajit shkurt nën drejtimin e Dr. Sheri Vulfit. Trajnimi u mbajt për gjashtë ditë me radhë, duke filluar të premten me 13 shkurt, me ç'rast u mbajt trajnimi për 20 zyrtarët e demokratizimit të OSBE-së. Ishte ky një rast i mirë për t'i prezantuar para OSBE-së metodat e punës që NDI ka planifikuar t'i përdorë. OSBE-ja ka në plan që të mbajë sesione trajnuese për Ligjin e TLI dhe së këndejmi, ka kërkuar paraprakisht nga NDI-ja që të mbështetet në manualin e njejtë.

Gjatë javës, prej datës 16 deri me 20 shkurt, Dr. Vulf mbajti trajnime çdo ditë, duke ia kushtuar ditën e hënë dhe të martë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ndërsa ditët tjera të javës, zyrtarëve të ministrive nga IPVQ-të dhe qeverive komunale. Në këtë trajnim, gjatë tërë javës morëm pjesë 50 pjesëmarrës, 30 nga të cilët ishin zyrtarë të ministrive të nivelit qendror dhe lokal, ndërsa 20 ishin deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Kosovës. Veç kësaj, Z. Edmond Efendija mbajti një trajnim joformal edhe për ca nga anëtarët e stafit të Kuvendit.

Pjesëmarrësit e trajnimit treguan një interesim mjaft të madh, sidomos kur ushtrimet mbaheshin tok me zyrtarët e ministrive. Ushtrimet e mbajtura gjatë trajnimit u përqëndruan kryesisht me simulimin e situatave, që mund të paraqiten kur qytetarët kërkojnë ndihmë nga zyrtarët e qeverisë për të pasur qasje në një dokument të caktuar.

Deputetët e Kuvendit nuk morrën pjesë në këto trajnime, ngase

trajnimi i mbajtur për Kuvendin është përqëndruar në shfrytëzimin e ligjit si mjet mbikëqyrës. Megjithatë, deputetët e Kuvendit bënë edhe disa pyetje mjaft me mend dhe interesante si dhe u inkuadruan në diskutime, për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ligjin, gjatë sesioneve të trajnimit.

Tani janë duke u diskutuar procedurat vijuese të trajnimit dhe për to do të vendoset në javët e ardhshme

Pet Kedli

Drejtor i Programit të NDI-së për Mbështetje Legjislative

Misioni i Projektit SPEAK në Parlamentin e Shqipërisë

Vizita mundësoi këmbimin e njohurive të fituara nga Projekti SPEAK me Sekretariatit e Parlamentit të Shqipërisë dhe anëtarët e Parlamentit. Me këtë rast, zyrtarët e Parlamentit u njohën shkurtimisht lidhur me progresin e bërë për krijimin e një sistemi të menaxhimit elektronik të dokumenteve në Kuvendin e Kosovës. Njëherazi, kjo vizitë ndihmoi edhe në zhvillimin e sinergjisë midis Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit të Shqipërisë, që do të mund të çonte në një bashkëpunim të ndërsjellë në të ardhmen. Ky bashkëpunim do të përqëndrohej në këmbimin e informatave, njohurive dhe përvojave të fituara në shfrytëzimin e teknologjisë informative për reformimin dhe menaxhimin e punës legjislative. Misionit i është dhënë mirënjohje nga një bibliotekë e organizuar mjaft mirë dhe nga Seksioni për Hulumtime, që është në shërbim të Parlamentit të Shqipërisë.

Vlen të theksohet se misioni pati kënaqësinë të takohej edhe me Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Servet Pëllumbin, me Sekretarin e Përgjithshëm, z. Artan Banushin si dhe me një numër të personelit të tij.

Vizita në Tiranë ishte gjithashtu edhe një rast për ta ndjekur një seminar për Rolin e Parlamentit në Procesin e Integritimeve Europiane, i sponsorizuar nga Unioni Inter-parlamentar në bashkëpunim me Parlamentin e Shqipërisë dhe UNDP- Shqipëri.

Programi përfshinte një numër prezantimesh, duke i përfshirë këto:

- Z. Ledio Bianku, drejtor i "Qendrës evropiane dhe kryesues i Klubit 2002" mbi rolin e parlamentit në procesin e integritimit;
- Z. Selami Xhepa, "Qendra Shqiptare për Tregëti Ndërkombëtare" mbi aspektet ekonomike dhe çmimin e integritimit për Shqipërinë;
- Z. Mihail Baciu, anëtar i Parlamentit të Rumanisë, lidhur me rolin e Komisionit për Integritim të Parlamentit të Rumanisë në procesin e integritimeve;
- Dr. Juhaz Lazlo, Ekspert për integritime evropiane në Parlamentin e Hungarisë, rreth rolit të Parlamentit Hungarez në negociatat e asociimit dhe implementimi i asociimit me UE në Hungari;
- Znj. Ermenlinda Meksi njoftoi grupin për procesin e Shqipërisë.

Seminari ishte me dobi të ndërsjellë dhe u vlerësua me komente shumë pozitive nga afro 50 anëtarë të Parlamentit dhe personelit të Kuvendit që i ndoqën punimet e tij. Të gjitha prezentimet e bëra në gjuhën shqipe i janë siguruar Kuvendit të Kosovës dhe UNDP-së në Kosovë. Gjithashtu, prezentimet e z. Baciu dhe Dr. Lazlos janë në dispozicion në gjuhën angleze.

Roxher. F. Roj

Menaxher i Projektit Projekti, SPEAK në përkrahje të Kuvendit të Kosovës

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjyhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikën Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar (IPU), Departamenti i Demokratizimit të OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



<http://www.kuvendikosoves.org>
<http://www.skupstinakosova.org>
<http://www.assemblyofkosovo.org>

Fotografitë nga:

UNMIK-DPI (fq. 1, 4, 8, 9); Bota Sot (fq. 6); Lumni Rama-OSBE (fq. 3, 5, 10, 11, 15, 18, 19, 21, 22, 24); Hasan Sopa-OSBE (fq. 7, 16); Lubomir Kotek - OSBE (fq. 12, 13, 20, 24); OSBE DD/ARC (fq. 14, 16)

